



MINISTRIA E DREJTËSISË

Raporti vjetor 2021



Mars 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

I. Informacion përmblendhës mbi Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe Planit të Veprimit 2021-2025

- 1.1 Metodologjia e monitorimit
- 1.2 Konsultimi publik

II. Progresi i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë

- 2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës
- 2.2 Impakti i zhvillimit të sektorit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjërë
- 2.3 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integrimit evropian
- 2.4 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit
- 2.5 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

III. Progresi i lidhur me qëllimet politike, objektivat specifike dhe masat

- 3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit
- 3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit
- 3.3 Konkluzione dhe rekomandime

IV. Risqet /risku dhe hapat për të adresuar

- 4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit
- 4.2 Hapat e radhës

ANEKSE:

ANEKSI I: RAPORTIMI I MASAVE

ANEKSI II: RAPORTIMI I INDIKATORËVE

Lista e shkurtimeve

AT	Asistencë teknike
BE	Bashkimi Evropian
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
CAMS	Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve të Shërbimit të Prokurorisë Shqiptare
DHASH	Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
DHKN	Dhoma Kombëtare e Noterëve
DHKPGJP	Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
GP	Grup pune
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
IPSIS	Sistemi Informatik i Planifikimit të Integruar
IT	Teknologjia e informacionit
JFA	Projekti “Justice for all”
KE	Këshilli i Evropës
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
KPA	Kolegji i Posaçëm i Apelit
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
OJQ	Organizata joqeveritare
OSFA	Fondacioni “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PP	Prokuroria e Përgjithshme
OZHQ	Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPAK	Struktura e Posaçme Antikorrupsion
TF	Task Forca
SASPAC	Ajencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
IPA	Instrumenti i Asistencës Para-Anëtarësimit
QP	Qëllim Politike
OS	Objektiv Specifik

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2021-2025

Prej vitit 2011 Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, e cila është një dokument politikash që synon një qasje më të lartë në drejtësi, rritjen e besimit të publikut tek pavarësia dhe mirëfunksionimi i tij, duke forcuar kontributin e këtij sektori në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, si dhe inkurajon përshejtimin e integritit evropian. Prej nëntorit 2014, bazuar në këtë qëllim, u vendosën hapat e parë cilësorë në drejtimit të hartimit dhe zbatimit të një reforme gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë, me synim krijimin e një sistemi të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit lehtësisht të aksesueshëm, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili gëzon besimin e publikut dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit duke patur prorititet dhe integrimin e tij në familjen evropiane. Një sistem drejtësie me këto tipare është parakusht i domosdoshëm për forcimin e shtetit të së drejtës, respektimin e lirive dhe të drejtave të individit, barazinë e shtetasve përpara ligjit, përparimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe ecurinë e procesit të integritit evropian.

Për sa më sipër duke marrë parasysh fazën në të cilën ndodhet reforma, nevojat imediate për rritjen e efektshmërisë së sistemit të drejtësisë dhe përshtatjen e fazave të reformës me kufijtë e buxhetimit të iniciativave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë kjo reformë është parashikuar të zhvillohet në 3 faza.

Faza I (2016-2020). Në këtë fazë u hodhën bazat ligjore dhe institucionale të reformës në drejtësi, përfshirë ndryshimet kushtetuese dhe ndryshime të tjera legjislative në të gjithë sektorin, duke e sjellë kornizën ligjore në standardet evropiane. U krijuan institucione të reja në përputhje me modelet evropiane dhe nisi dhe vijoi me hapa të shpejtë procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve.

Faza II (2021-2025). Pas përfundimit të fazës së parë të reformës në drejtësi, Qeveria e Republikës së Shqipërisë vijoi me hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë **2021-2025** (SND II), me qëllim konsolidimin e kuadrit institucional, zbatimin e praktikave moderne evropiane në drejtësinë penale, përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të drejtësisë dhe mundësi të reja për teknologjinë e informacionit, përfshirë zgjidhje inovative elektronike, që mbështesin një rritje thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë.

Faza III (4-5 vite pas fazës II). Konsiderohet si faza e fundit e reformave madhore¹. Në këtë fazë synohet të eliminohet *backlog*-u dhe të rritet cilësia e shërbimeve dhe të ofrohet një drejtësi në të njëjtat nivele si në vendet e BE-së. Duhet theksuar se në fund të vitit 2025 do të ketë përfunduar

¹ Reformat mund të vijnë edhe pas përfundimit të fazës III, por është parashikuar që do të jenë të lidhura me përmirësimet graduale në nivel institucional, por pa përfshirë reforma të gjera ndërsektoriale.

pjesa më e madhe e konsolidimit të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, e përmirësimit të kuadrit rregullator dhe metodologjik, të trajnimit të magjistratëve si dhe kandidatëve për magjistratë, si dhe do të jenë forcuar kapacitetet e Ministrisë së Drejtësisë. Prandaj, faza e tretë e SND-së, që mbulon një periudhë 4-5 vjeçare, nga viti 2026 e në vazhdim, do të përqendrohet në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga gjykatat, institucionet e drejtësisë penale, nga disa prej institucioneve të tjera të varësisë dhe drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në investime të lidhura me infrastrukturën.

Me qëllim garantimin e progresit të reformës përmes një kuadri të plotë strategjik, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 823, datë 24.12.2021 miratoi *Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 dhe planin e saj të veprimit*. Së bashku me dy dokumentet e lartpërmendura strategjike u miratua edhe Pasaporta e Treguesve, me anë të së cilës janë përcaktuar tregues të matshëm të realizimit të objektivave të kësaj strategjie.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 290, datë 11.4.2020 “*Për krijimin e bazës të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)*”, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025 është një dokument i konsultuar gjerësisht me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Drejtësisë, dhe i miratuar nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri. Plani i Veprimit dhe buxhetet e detajuara janë punuar sipas sistemit IPSIS.

Duke marrë parasysh se sistemi i drejtësisë përbëhet nga një numër i konsiderueshëm institucionesh të pavarura, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë është konceptuar si një strategji ombrellë, e cila do të përmbajë kryesisht objektivat më të rëndësishëm dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj. SND 2021-2025 plotësohet me Planin e Veprimit, në të cilin jepen në mënyrë të detajuar masat që secili institucion do të ndërmarrë në përmbushje të çdo objektiwi specifik të qëllimeve të politikës sipas afateve të mirëpërcaktuara.

Plani i Veprimit 2021-2025, kaloi nëpër një proces konsultimi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë, institucione të administratës shtetërore në nivel qendror dhe institucione të pavarura, organizata dhe partnerë ndërkombëtarë, shoqëri të qytetërimit etj.

Vizioni i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025 është: “*Sistem i drejtësisë i pavarur, llogaridhënës, i aksesueshëm, transparent dhe eficient që mbron të drejtat e njeriut dhe i shërben shoqërisë sipas standardeve evropiane*”.


Qëllimet e Strategjisë janë ndarë në objektiva për të bërë të mundur një organizim më të ngushtë dhe të drejtpërdrejtë të masave të parashikuara dhe të lidhura me to. Është aplikuar formati i parashikimit të masave me *target/milestones*. Në SND 2021-2025 parashikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse vizioni i strategjisë, qëllimet e politikës, objektivat specifikë për secilin qëllim,

rezultatet e pritshme dhe masat e nevojshme për arritjen e secilit objektiv. Dokumenti parashikon treguesit kryesorë të performancës, me qëllim matjen e arritjeve, metodave të koordinimit, monitorimit dhe raportimit, dhe buxhetin e përgjithshëm të zbatimit të tij. Plani i Veprimit 2021-2025, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, konsiston në:

- 4 Qëllime Politike
- 17 Objektivat Specifikë²
- 186 masa.

Për këtë periudhë monitorimi, *Janar-Dhjetor 2021*, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna për 16 objektivat specifikë dhe 155 masa, të shpërndara përkatësisht në: 22 masa për qëllimin e parë; 51 masa për qëllimin e dytë, 46 masa për qëllimin e tretë, 36 masa për qëllimin e katërt.

Rezulton se janë realizuar nga institucionet përgjegjëse për vitin 2021 plotësisht 57 masa, 52 prej tyre rezultojnë në proces realizimi, 46 prej tyre rezultojnë të porealizuara.




Totali i treguesve të performancës për të katërta qëllimet për vitin 2021 është 28, këto tregues janë të shpërndarë përkatësisht 7 tregues për objektivat specifikë në qëllimin e parë, 7 tregues për objektivat specifikë në qëllimin e dytë, 8 tregues për objektivat specifikë në qëllimin e tretë dhe 6 tregues në qëllimin e katërt.

²Shënim për në vijim të raportit: *Nuk është përfshirë Objektivin 3.3 në lidhje me Drejtësinë Penale për të Mitur. Kjo referencë është bërë në këtë dokument strategjik në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur. Plani i masave në zbatim të këtij objekti specifik nuk është përfshirë në planin e veprimit të SND 2021-2025 për të shmangur mbivendosjen me masat e parashikuara në Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur.

Nga totali prej 25 tregues performance analizuar për vitin 2021, janë arritur vlerat e synuara për 17 tregues performance, pjesërisht për 6 tregues performance dhe nuk janë arritur për 2 tregues performance.

Qëllimi i Politikës	Treguesit e performancës ³	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ⁴	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ⁵	Vlera e synuar nuk është e realizuar
Qëllimi i Parë	7	3	2	2
Qëllimi i Dytë	7	6	1	0
Qëllimi i Tretë	6	5	1	0
Qëllimi i Katërt	5 ⁶	3	2	0
Total	25⁷	17	6	2



³ Treguesit e performances të analizuar për katër qëllimet e politikës për vitin 2021

⁴ Referuar metodologjisë rezulton plotësisht i realizuar

⁵ Referuar metodologjisë rezulton pjesërisht i realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁶ Qëllimi i katërt ka 6 indikatorë, por Indikatori i objektivit specifik 2.4 nuk mund të matet për vitin 2021.

⁷ Për vitin 2021 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor raportohet se të dhënat janë të padisponueshme për dy indikator. Pritet që dy indikatorët e institucionit të KLGJ-së të analizohen në muajin Prill 2022, në kuadrin e analizës vjetore të KLGJ. Gjithashtu, indikatori i objektivit specifik 4.1 pritet të fillojë realizueshmërinë pas vitit 2021. Në këtë kuadër për vitin 2021 janë marrë në analizë 25 indikatorë.

Në vijim, paraqitet realizueshmëria e objektivave të strategjisë sipas shkallës së realizimit të masave dhe treguesve të performancës.

Objektivat		Shkalla e realizimit sipas Objektivit Specifik	Shkalla e realizueshmërisë sipas treguesit të performancës
Qëllimi I i Politikës	1.1 Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligji.	92%	139%
	1.2 Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin e përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin.	83%	98%
	1.3 Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse.	67%	84%
Qëllimi II i Politikës	2.1 Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe efikasitetin.	56%	100%
	2.2 Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese, sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesionale, në mënyrë transparente dhe efektive.	92%	100%
	2.3 Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke siguruar një numër të përshtatshëm të magistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.	78%	74%

	2.4 Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë Gjykatën e Lartë, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.	28%	_8
	2.5 Aksesimi i drejtësisë i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme.	78%	160 %
Qëllimi i III i Politikës	3.1 Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese.	86%	100%
	3.2 Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekja efikase të korrupsionit dhe e krimit të organizuar.	75%	69%
	3.3 Përmirësimi i drejtësisë për të mitur, duke garantuar një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të lartë të tyre.	-	_9
	3.4 Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdorstandartet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikatat dhe standardet më të mira të BE-së	29%	105%
	3.5 Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individuale.	75%	100%
	Qëllimi i IV i	4.1 Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuar, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative,	13%

⁸ Objektivi 2.4 nuk mund të matet pasi për dy indikatorë nuk ka vlera që raportohen për këtë raport monitorimit. Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton se të dhënat janë të padisponueshme. Pritet të analizohen muajin Prill 2022, në kuadrin e analizës vjetore të KLGJ.

⁹ Shënim për në vijim të raportit: *Nuk është përfshirë Objektivi 3.3 në lidhje me Drejtësinë Penale për të Mitur. Kjo referencë është bërë në këtë dokument strategjik në kuadër të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur. Plani i masave në zbatim të këtij objekti specifik nuk është përfshirë në planin e veprimit të SND 2021-2025 për të shmangur mbivendosjen me masat e parashikuara në Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur.

¹⁰ Nuk mund të matet në vitin 2021, fillon zbatueshmërinë në vitet në vijim.

civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare.		
4.2 Përmirësimi i koordinimit, menaxhimit të performancës dhe të sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS.	28%	100%
4.3 Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, i burimeve dhe i mbështetjes për institucionet e saj të varësisë.	53%	90%
4.4 Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar dhe përgatitja e Shqipërisë për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me <i>acquis</i> e BE dhe aktet e tjera të integritimit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë.	55%	100%

Përsa më sipër, nga analiza e kryer rezulton se, progresi i arritur për secilin prej qëllimeve të politikave, I– II – III – IV paraqitet:

Qëllimi i Parë i Politikës Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien.	81%
Qëllimi i Dytë i Politikës Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane.	108%
Qëllimi i Tretë i Politikës Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.	95%
Qëllimi i Katërt i Politikës Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.	73%

Arritjet kryesore për vitin 2021

Në mënyrë të përmbyllur viti 2021 ka shënuar disa arritje të rëndësishme në Qëllimin e Politikës I, II, III, IV në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, ku konkretisht mund të përmendim:

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nga 120 dosje të parashikuara për tu vlerësuar për vitin 2021, ka përmbyllur 167 dosje, duke tejkaluar kështu me 39% synimin e vendosur.
- Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shpallur për periudhën Janar - Dhjetor 2021, 38 vendime duke vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit - në 29 vendime; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare - në 1 vendim; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit - në 5 vendime; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit - në 1 vendim; prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke urdhëruar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë kryerjen e procesit të rivlerësimit - në 1 vendim; prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit - në 1 vendim. Sa i përket denoncimeve nga publiku, gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2021, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar dhe trajtuar 151 denoncime.
- KLGJ ka parashtruar draftpropozimet ligjore mbi paketën e efikasitetit miratuar nga Kuvendi në mars të 2021. Pjesë e kësaj pakete ishin ligjet bazë të reformës ndër të cilat përmendim ligjin Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Për të shmangur efektet e uljes së numrit të prokurorëve nga procesi i vetingut, Kuvendi i RSH, me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm ka shtuar 30 vende për oficerë të policisë gjyqësore në strukturën e prokurorisë, shoqëruar me fondin përkatës nga Ministria e Financave. Në vijimësi, duke analizuar kërkesat dhe nevojat e prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm janë kryer ndërhyrje strukturore për funksionimin sa më eficient të prokurorëve.
- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë që në vitin e parë të funksionimit (2020) dhe duke vijuar në vitin 2021, ka nisur ngritjen e grupeve të punës për administrimin dhe kategorizimin e ankesave të dorëzuara pranë organeve kompetente gjatë periudhës kalimtare deri në krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pas përfundimit të procesit të kategorizimit, ka vijuar puna me shpërndarjen e ankesave me objekt magjistratë prokurorë dhe gjyqtarë të administruara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas një përparësie të caktuar.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë, lidhur me rritjen e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë që nga krijimi i institucionit. Konkretisht Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për trajnimin e njësisë së inspektorëve deri tani, ka patur bashkëpunime me organizata të huaja si TaieX, Opat, Cepej, Misioni Euralius V etj, dhe me ASPA-n. Me partnerë të huaj janë kryer 9 trajnime gjatë vitit 2021

- Është rinovuar rrjeti informatik i Gjykatës Kushtetuese, janë siguruar *software-et* dhe *hardwar-et* e planifikuara.
- Është krijuar databaza e të dhënave të lektorëve dhe trajnerëve të Shkollës së Magjistraturës, që kanë njohuri mbi legjislacionin e BE-së. Është kryer identifikimi nga pikëpamja sasiore të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që do të trajnohen lidhur me legjislacionin dhe standardet e BE-së dhe praktikën ndërkombëtare. Gjatë kësaj periudhe zbatimi të planit të veprimit, janë identifikuar edhe problematika, duke ndikuar në realizueshmërinë e disa prej objektivave të strategjisë dhe në arritjet e qëllimit themelor dhe përfundimtar të politikave.
- 8153 persona kanë përfituar ndihmë juridike parësore gjatë vitit 2021 duke tejkaluar duke rritur vlerën e synuar me 94.12%.
- % e inspektimeve të kërkuara ligjërish për noterët publikë të kryera nga MD janë tejkaluar nga vlera e synuar për vitin 2021, duke arritur në 63%.
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë pas kryerjes së analizës në lidhje me nevojën për hartimin e legjislacionit, ka ndërmmarrë të gjitha proceset për të hartuar draft-aktet nënligjore sipas ndryshimeve të paketës legjislative penitenciare. Gjithashtu, janë hartuar të gjitha rregulloret, ku ndër to është në proces miratimi Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve me Vendim të Këshillit të Ministrave.
- Është kryer studimi i status *quo-së* dhe analiza e ndërhyrjes për Kodin e Procedurës Penale (KPP). Është përgatitur projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 të ndryshuar, i cili iu përcoll për mendim institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare.
- DPB është në hapat e fundit të finalizimit të programit "Aftësitë për jetën", të cilat do të adresojnë nevojat e të burgosurve në funksion të rehabilitimit holistik të tyre dhe riintegritimit të mëtejshëm në shoqëri. Gjatë vitit 2021, janë miratuar 2 manuale të rëndësishme për stafet e kujdesit psiko-social në IEVP, për punën rehabilituese me personat me probleme të abuzimit/varësisë nga substancat narkotike, të rinjtë e grupmoshës 18-21 vjeçare, personat me probleme të shëndetit mendor, vlerësimi i riskut dhe i nevojave.
- Gjatë vitit 2021 mbipopullimi është eliminuar plotësisht dhe aktualisht ndodhemi në kushtet e nënpopullimit të burgjeve. Mesatarisht popullimi gjatë 2021 ka qenë -590 vende, ose -14%. Eliminimi i mbipopullimit në burgje ka ardhur si rezultat i masave konkrete në investime, si rikonstruksioni i dy godinave në IEVP Lezhë, investim i Qeverisë Shqiptare, ashtu edhe përmes kryerjes rast pas rasti të një studimi të kujdesshëm të shpërndarjes dhe akomodimit të burgosurve në IEVP.
- Është rishikuar dhe miratuar Ligji Nr.10193 datë 3.12.2009 "*Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet Huaja në Çështjet Penale*" I ndryshuar 97/21 datë 7.7.2021.

Sfida kryesore të zbatimit të planit të veprimit për vitin 2021

Gjatë këtij viti zbatimi të planit të veprimit, janë identifikuar edhe problematika, duke ndikuar në realizueshmërinë e disa objektivave të dokumentit të politikave dhe në arritjet e qëllimit total të politikave, ku konkretisht përmendim:

- Problematika që lidhen me mjedisin e brendshëm rregullativ, kapacitetet planifikuese e administrative, proceset operationale dhe komunikimi;

- Moskandidimi i magjistratëve gjyqtar në pozicionin e inspektorit magjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka sjellë si pasojë mungesa në burime njerëzore në njësinë e magjistratëve.
- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka hasur pamundësi financiare në zërin paga për të mbuluar shpenzimet e punonjësve.
- Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në ka shfaqur vonesa për shkak të miratimit me vonesë të Rregullores *"Për vlerësimin e Prokurorëve"*.
- Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të ILD-së është konkretizuar për të vënë në lëvizje iniciativën përkatëse, por nuk u shqyrtua dhe nuk u përfundua. Gjatë vitit 2021, nevoja për ndryshimet ligjore të sipërpërmendura u bë pjesë e raportit të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore si një nga problematikat e hasura të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
- Në kuadër të realizimit të masave të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve si problematikë theksohet ngritja e grupeve për të hartuar planet e punës për implementimin e tyre.
- Shërbimi i Provës raporton se përgatitja e programeve të bashkëpunimit me KLGJ-në, KLP-në, PP-në, SHM-në ka qënë e pamundur për tu realizuar për shkak të rishikimit të strukturës organike të institucionit.
- Masat e ndërmarra në kuadër të menaxhimit të pandemisë së COVID - 19 kanë afektuar hartimin dhe miratimin e skemës dhe standardeve për mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin, vlerësimin e performancës për IEVP si dhe pilotimin e skemave në 4 IEVP.
- Përgatitja e moduleve të programeve për parandalimin e recedivizmit për krimet seksuale, personat e dhunshëm si dhe për personat e varur nga droga, alkooli dhe pilotimi në 8 IEVP është vështirësuar si rrjedhojë e mungesës së ekspertëve të posaçëm.
- Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare është penguar për shkak të vonesave në ngritjen e QTI dhe mungesës së kapaciteteve të burimeve njerëzore.
- Një nga problematikat kryesore gjatë realizimit të proceseve në kuadër të integritetit evropian lidhet me lëvizjen e shpeshtë të anëtarëve të GNPIE-ve, duke sjellë një paqëndrueshmëri të grupeve të punës, e cila ndikon dhe në realizimin e proceseve të punës.

1.1 Metodologjia e monitorimit

Koordinimi institucional për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 128, dt. 08.11.2021 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues si dhe hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive. Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit.

Ministria e Drejtësisë kryen koordinimin dhe organizimin e takimeve me të gjitha institucionet kontribuese, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit dhe performancës. Raporti i monitorimit të dokumentit strategjik (SND) për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2021 është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga institucionet përgjegjëse dhe kontributore të planit të veprimit.

Periodiciteti i hartimit të Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raporte gjashtëmujore dhe vjetore për monitorimin dhe raportimin e dokumenteve strategjike, të cilët do të prodhojnë informacion të nevojshëm dhe në kohë për politikëbërësit mbi progresin e zbatimit të masave që janë parashikuar në planin e veprimit të SND-së për 5 vitet e ardhshme.

Manuali i Raportimit sipas sistemit IPSIS

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse sipas manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS. Sipas këtij dokumenti strategjik, secili institucion raporton mbi nivelin e zbatimit të çdo objektivi dhe mase, mbi buxhetin e caktuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në përgjithësi. Bashkërendimi për respektimin e manualit të hedhjes së të dhënave në sistemin IPSIS do të kryhet me Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC).

Përputhshmëria e raporteve të monitorimit dhe performancës me parimet e Mirëqeverisjes

Ministria e Drejtësisë do të hartojë raportin e monitorimit dhe të performancës për periudhën përkatëse në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

Parimet e Mirëqeverisjes përmbajnë një kornizë të vlerësimit të Raporteve të Monitorimit dhe të Performancës e cila mundëson analizën e rregull të progresit të arritur në zbatimin e Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbush vendi.

Parimet janë të hartuara për vendet që duan të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Kushtet e acquis, si dhe direktivat dhe udhëzimet e tjera të BE-së, janë thelbi i Parimeve në fushat ku ekzistojnë acquis. Në fushat e tjera,

Parimet rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikat e mira në shtetet anëtare të BE-së dhe në vendet anëtare të OECD-së. Si standard minimal për një administratë të mire të orientuar drejt performancës, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre Parimeve themelore. Bashkëndimi për vlerësimin e raportit të monitorimit¹¹ dhe të performancës lidhur me përmbushjen e këtyre parimeve do të kryhet me Njësinë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

Mekanizimi i Integruar i Politikave

Komiteti Drejtues Sektorial për Reformën në Drejtësi do të operojë në nivel teknik përmes dy grupeve tematike, të cilat do të jenë pjesë e grupit për menaxhimin e integruar të politikave për sektorin e drejtësisë dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse, si dhe nëpërmjet sekretariatit teknik, i cili do të formalizohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë. Grupet tematike do të jenë në përputhje dhe në zbatim të urdhrat të Kryeministrit nr.157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale / ndërsektoriale dhe krijimin e funksionimit të një mekanizmi të integruar sektorial / ndërsektorial”.

1. Grupi tematik për funksionimin e plotë të sistemit të drejtësisë dhe aksesit në drejtësi.
2. Grupi tematik për drejtësinë penale.

Në mbledhjet e grupeve tematike do të diskutohen raportet, problematikat dhe pengesat që dalin gjatë zbatimit të SND-së dhe ushtrimit normal të aktiviteteve të institucioneve përkatëse, të cilat kërkojnë një qasje të përbashkët, si dhe hapat që do të ndiqen për realizueshmërinë e tyre.

Gjithashtu, do të synohet koordinimi midis institucioneve të drejtësisë penale në nivel menaxhimi për parandalimin e krimit, që do të përgatisë dhe zhvillojë konceptin e një zinxhiri të integruar të institucioneve të drejtësisë penale me një qasje të koordinuar dhe të përbashkët për konceptin e ri të propozuar për sektorin e drejtësisë penale.

Fazat për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Fazat që do të ndiqen për përgatitjen dhe konsolidimin e raportit dhe monitorimit të performancës, paraqiten si më poshtë:

Faza 1: dërgimi i kërkesës për kontribut në datë 27 janar 2021 për të gjitha institucionet raportuese dhe konsolidimi i paketës në përputhje me standardet e sistemit IPSIS dhe Parimet e Mirëqeverisjes;

Faza 2: dërgimi i paketës së plotë për vlerësim më datë 18.03.2021 pranë Njësisë e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri për vlerësim të raportit të performancës në përputhje me parimet e mirëqeverisjes.

¹¹ Para se raporti i monitorimit dhe performancës të aprovohet në strukturat vendimmarrëse

Faza 3: konsolidimi i paketës pas marrjes dhe reflektimit të komenteve të sjella nga Njësia e Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri;

Faza 4: dërgimi i paketës së plotë për njohje dhe/ose vlerësim pranë Agjencisë SASPAC;

Faza 5: organizimi i mbledhjes së KDS-së më datë 31.03.2021 për konsultimin e paketës së konsoliduar, marrjen e komenteve nga aktorët, si dhe miratimi i tij;

Faza 6: reflektimi i komenteve dhe finalizimi i paketës së raportit të monitorimit dhe performancës;

Faza 7: publikimi i raportit vjetor në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë;

Faza 8: dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së KDS-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Njesisë së Mirëqeverisjes, Departamenti i Politikave dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri.

Faza 9: dërgimi i procedurave (minutat e takimit, konkluzionet operacionale, raporti i konsultimit publik) të mbledhjes së KDS-së dhe paketa finale, së bashku me linkun për njohje Agjencisë SASPAC.

Parimet e Mirëqeverisjesqë do të merren në konsideratë për hartimin e Raportit të Monitorimit dhe Performancës

Raporti i Monitorimit dhe Performancës do të zbatohet parimet e mirëqeverisjes që do të duhet të ndiqen në zbatimin e një sistemi të mirë dhe efektiv të M & R-së:

- **EFIKASITETI:** Agregimi i niveleve të dokumenteve. Ky parim duhet të lejojë shfrytëzimin e sinergjive mes raporteve të dokumenteve të ndryshme. Nëse dokumentet janë të lidhura ngushtë në aspektin e përmbajtjes, atëherë sistemi i M & R-së duhet ta marrë këtë parasysh për të mundësuar zhvillimin e mëtejshëm të njëri-tjetrit dhe jo mbivendosjen e njëri-tjetrit. Elementet bazë të raporteve të M & R-së (p.sh. objektivat, masat, indikatorët) në dokumentin e nivelit më të ulët do të zhvillohen drejt përmbajtjes së M & R-së në dokumentet e nivelit në të lartë. Duhet të merren parasysh lidhjet. Ky parim duhet të përmirësojë frekuencën dhe përmbajtjen e raporteve të M & R-së.
- **LLOGARIDHËNIA:** Respektimi i përmbajtjes së dokumenteve të planifikimit. Raportet e monitorimit duhet të përqendrohen në elementet e dokumenteve të planifikimit për të siguruar llogaridhënie lidhur me reformat dhe ndërhyrjet e planifikuara.
- **RËNDËSIA:** Respektimi i nevojave të përdoruesve të monitorimit dhe performancës. Raportet e M & R-së duhet të jenë të përshtatura për nevojat e përdoruesit në aspektin e përmbajtjes, gjatësisë dhe frekuencës. Për më tepër, raportet duhet të japin llogari për arritjen e rezultateve në mënyrë të verifikueshme dhe në raport me treguesit SMART.

Komponentët kryesorë që Raportet e Monitorimit dhe Performancës do të vlerësohen për përputhshmërinë me Parimet e Mirëqeverisjes lidhen me komponentët e mëposhtëm:

Qasja analitike e strukturuar bazuar në evidenca dhe konsultim

- Informacioni i dhënë shpjegon kuadrin metodologjik në përputhje me procedurat dhe standartet e sistemit
- Progresi ndaj secilit qëllim politik dhe objektivi specifik të strategjisë bazuar në tregues si dhe zbatimin e reformave kryesore në sektor është paraqitur qartë.
- Shkalla në të cilën palët kryesore të interesit janë përfshirë në procesin e hartimit të raportit dhe RM është konsultuar me të gjithë grupet si dhe publikuar në webin respektiv të institucionit (evidencë kryesore është raporti i konsultimit publik për procesin si dhe evidentimi që komentet janë marë në konsideratë).
- Shkalla e paraqitjes analitike të zhvillimeve të sektorit globalisht ose në rajon.
- Shkalla e paraqitjes analitike të zbatimit të strategjisë me efekte në axhendën e integritetit evropian.
- Shkalla e paraqitjes analitike lidhur me identifikimin e fushës e cila adresohet për përmirësim si dhe efektet në ekzekutimin përgjithshëm të buxhetit.

Progresi i arritur vs qëllimet e politikave, objektivat specifike dhe masat

- Shkalla në të cilën progresi shpreh qartë vlerësimin e arritjeve kryesore duke përdorur treguesit (KPIs)/duhet të vlerësohet analiza (grafikë, dashboards, analiza të thelluara dhe vizualisht përmes tabelave do të ishte vlerë e shtuar në rezultat). Gjithashtu paraqitet qartë identifikimi i shkallës së performancës.
- Shkalla në të cilën progresi adreson vlerësimin e sfidave, boshllëqeve dhe jo efikasitetit (identifikohet qartë në raport progres se cilat fusha (bazuar në qëllimet e politikave / objektivat specifike) tregojnë performancën më të dobët/jo rezultative, vs performancën më të lartë të QP, OS, duke përdorur treguesit e rezultateve. (grafikë, dashboards, analiza të thelluara dhe vizualisht përmes tabelave do të ishte vlerë e shtuar në rezultat).
- Treguesit e Performancës janë pjesë e analizës për cdo QP (qëllim politike) dhe cdo OS (objektivi specifik) dhe jepen me premisa krahasueshmërie në vite apo për periudha të caktuara (xx vs xx).
- Konkulzionet dhe rekomandimet janë të bazuara në përputhje me evidencat e raportit dhe japin masa konkrete për korrektim/përmirësim për tu adresuar në vendimmarrje.

Performanca e kategorizuar sipas standarteve

- Përcaktimi i nivelit të arritjes së objektivit të secilit tregues të performancës është identifikuar. Është kryer mbledhja e të dhënave të disponueshme. Është llogaritur norma e realizimit të treguesit: 1) vlera e synuar, 2) vlera bazë dhe 3) të dhënat për arritjen e synimit.

- Niveli i arritjes së objektivit është përcaktuar. Gjithashtu është llogaritur norma mesatare e zbatimit të të gjithë treguesve të performancës lidhur me cdo objektivi të veçantë. (është kryer hedhja e të dhënave të niveleve të realizimit të çdo treguesi të lidhur me performancën dhe pjesëtimin me numrin e treguesve të performancës).
- Niveli i përcaktimit të shkallës së realizimit të objektivit për një nga katër (4) intervalet e sistemit të performancës është kryer dhe analizuar. Gjithashtu Intervali është përcaktuar në bazë të nivelit të tolerancës. (i.dobët, ii. Mjaftueshëm, iii. Mirë, iv. Shumë mirë, v.Tejkualuar.

Rrisqet

- Shkalla në të cilën identifikohen rrisqet në nivel QP dhe OS në zbatim të Ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Shkalla në të cilën analizohen rrisqet në nivel QP dhe OS.
- Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë
- Vlerësimi i mundësisë së ndodhjes së riskut është kryer në përputhje me kategorizimet i.ulët; ii. mesëm dhe iii.lartë.

Analizat financiare

- Shkalla e analizës së kryer lidhur me (i) në buxhetin e përdorur në periudhën e monitorimit, (ii) hendekun e financimit dhe (iii) nevojat e ardhshme.
- Analiza e buxhetit të përdorur është analizuar e lidhur me programet buxhetore (identifikohen saktë numri total i programeve buxhetore) në tre (3) nivele: (i) qëllimi i politikave (ii) objektivi specifik (iii) masat/ produktet si dhe totali për strategjinë.
- Shkalla e analizës financiare është kryer ku janë identifikuar dhe shkaqet e mungesës së fondeve dhe se si ky hendek do të trajtohet në të ardhmen.

Plani i Veprimit

- Plani është zbërthyer në realizueshmërinë e masave.
- Janë identifikuar institucionet zbatuese dhe kodet referuese për programet buxhetore/lidhja 1/1.
- Janë identifikuar qartë periudha e realizueshmërisë.
- Institucionet e tjera/bashkëpunuese janë identifikuar.
- Masat/produktet për tre vitet janë të përputhura me produktet e programeve buxhetore (identifikohen qartë programet buxhetore).

Procedura për analizimin e të dhënave për raportin e monitorimit dhe performancës

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me parimet e mirëqeverisjes dhe strukturës vlerësuese për arritjen e performancës në Kryeministri.

Së pari është analizuar zbatimi i masave duke dhënë një rezultat sasior dhe cilësor të realizimit të tyre përkundrejt kryerjes së masave respektive të lidhura me to.

Së dyti është analizuar arritja e vlerës së synuar për këtë periudhë e përcaktuar në treguesit e performancës, duke vlerësuar gjithashtu edhe shkallën e ndikimit të masave të realizuara në arritjen e vlerës së synuar.

Së treti është analizuar realizimi i objektivëve specifike përmes përlllogaritjes së realizimit të treguesve të performancës dhe përqindjes së masave të lidhura me objektivin përkatës të realizuara.

Zbatueshmëria e masave të Planit të Veprimit klasifikohet me vlerat si më poshtë:

E zbatuar: është raportuar statusi “E zbatuar” për ato masa të cilat janë përmbushur.

Pjesërisht e zbatuar/Në proces: është raportuar statusi “Në proces” për ato masa, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.

E pazbatuar: Të pazbatuara janë raportuar ato masa të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa për të cilat nuk ka pasur progres.

Për përlllogaritjen e realizimit të objektivëve specifike sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të performancës është përdorur formula si më poshtë ¹²:

$$NR = \frac{TP\ 1\ NR + TP\ 2\ NR}{2\ TP} \times 100\%$$

Përlllogaritja e realizimit të objektivit përkundrejt zbatimit të masave është kryer në bazë të 4 intervaleve të sistemit të performancës si në tabelën dhe kodin e ngjyrave më poshtë:¹³

Kategoria	Niveli i Tolerancës	Pikët (110)
Dobët	Nga 0 deri në 30 për qind e masave të realizuara	30
Mjaftueshëm	Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara	20
Mirë	Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara	35
Shumë mirë	Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara	25
Tejkaluar	111 dhe më lart	N/A

Niveli tjetër i analizës është realizuar sipas qëllimeve të politikës. Bazuar në të dhënat e realizueshmërisë për secilin nivel analitik (masa, tregues performance, objektiv specifik) është vlerësuar secili nga katër qëllimet e politikave:

¹² Formula e përlllogaritjes është marrë nga guida metodologjike e hartimit të raporteve të monitorimit të dokumenteve strategjike IPSIS.

¹³ Vlerësim është realizuar në përputhje me Guidën Metodologjike “Struktura e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale për agjendën e mirëqeverisjes”.

1. Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënie;
2. Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane;
3. Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit;
4. Koordinimi, manaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.

Matrica e Riskut

Në raportin e monitorimit vlerësohet identifikim i risqeve me qëllim identifikimin e hapave që do të duhen të ndiqen për tu adresuar në kuadër të implementimit të objektivëve të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Vlerësimi i riskut është kryer në përputhje me tabelën më poshtë¹⁴:

Mundësia	E lartë	3	6	9	
	E mesme	2	5	8	
	E ulët	1	4	7	
		E ulët	E mesme	E lartë	
		Ndikimi			

Konsultimi publik i raportit të monitorimit dhe performancës

Në përputhje me kriteret ligjore për konsultimin publik, pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë e dërgoi në datën 18.03.2022 dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe me datë 18.03.2022 publikoi draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve, në

¹⁴ Analiza dhe vlerësimi i riskut është kryer referuar Guidës Metodologjike për hartimin e raporteve të monitorimit për Agjendën e Mirëqeverisjes.

faqen e internetit www.drejtësia.gov.al, në menu prioritete/strategjia ndërsektoriale/ Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë .

Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit dhe vijoi me zhvillimin e një takimi të dedikuar, në kuadër të diskutimit të analizës së kryer, gjetjeve të raportit, vlerësimit të qëllimeve të politikës në prezencë të të gjithë institucioneve zbatuese dhe raportuese të planit të veprimit.

Raporti i konsultimit publik të raportit të monitorimit publikohet gjithashtu në faqen e internetit të ministrisë, www.drejtësia.gov.al.

II. PROGRESI I STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË DREJTËSISË

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë ka si synim arritjen e objektivave madhorë nëpërmjet realizimit të masave konkrete, me qëllim zhvillimin e një shoqërie në të cilën ekziston një sistem i përgjegjshëm dhe efikas i drejtësisë, ku llogaridhënia e institucioneve të drejtësisë, funksionimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë sjellin rezultate të prekshme. Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin apo/dhe sfidat drejt përbushjes së objektivave të strategjisë, nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacioni nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e SND-së. Vleresohet e nevojshme të kryhet një analizë e thelluar e orientimeve të dokumentit të politikave për të evidentuar hapat që duhet të ndiqen në zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm. Për të monitoruar ecurinë e reformës në drejtësi, është hartuar raporti periodik i rradhës, në kuadër të zbatueshmërinë e masave të Planit të Veprimit 2021– 2025, i cili mbulon periudhën 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021.

2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin 2021

Reforma në Drejtësi konsiderohet një proces prioritar për vendin, si një element element i kyç përmes të cilit Qeveria Shqiptare garanton konsolidimin e pavarësisë dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë, rritjen e transparencës dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë; përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së sistemit penitenciar dhe i masave të sigurisë. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, së bashku me dokumentet strategjike shoqëruese harmonizohet dhe është në përputhje të plotë me qëllimet, objektivat dhe parashikimet e *Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II)* sipas shtyllës “Mirëqeverisja, demokracia dhe shteti i së drejtës”.¹⁵

¹⁵ Shih: https://www.kryeministria.al/ep-content/uploads/2017/09/SKZHI_FINAL_QBZ.pdf

Synohet që ky dokument strategjik të jetësohet përmes katër qëllimeve të politikës.

- **Qëllimi i Parë i Politikës:** Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien.
- **Qëllimi i Dytë i Politikës:** Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane.
- **Qëllimi i Tretë i Politikës:** Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.
- **Qëllimi i Katërt i Politikës:** Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, përmban 16 objektiva specifike, të cilët janë:

Qëllimi i Parë i Politikës : Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve

OS 1.1: Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit.

OS 1.2: Përditësimi dhe përmirësimi i legjisllacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjisllacionin për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin.

OS 1.3: Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përbush rregullat dhe standardet përkatëse.

Qëllimi i Dytë i Politikës: Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi

OS 2.1: Rishikim të kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe efikasitetin.

OS 2.2: Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesional, në mënyrë transparente dhe efektive.

OS 2.3: Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke siguruar një numër të përshtatshëm të magistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri..

OS 2.4: Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.

OS 2.5: Akses i efikas në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes, alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme.

Qëllimi i Tretë i Politikës: Sistem koherent i drejtësisë penale, i mbështetur në parimet moderne të drejtësisë

OS 3.1: Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese.

OS 3.2: Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekja efikase të korrupsionit dhe e krimin të organizuar.

OS 3.3: Përmirësimi i drejtësisë për të mitur, duke garantuar një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të lartë të tyre.

OS 3.4: Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operationale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së.

OS 3.5: Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individuale.

Qëllimi i Katërt i Politikës: Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucionet e sektorit

OS 4.1: Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare.

OS 4.2: Përmirësimi i koordinimit, menaxhimit të performancës dhe sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS.

OS 4.3: Zhvillimi i kapaciteteve të MD-së dhe rritja e burimeve, si dhe rritja e mbështetjes për institucionet e saj të varësisë.

OS 4.4: Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar dhe përgatitja e Shqipërisë për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjisllacionit shqiptar me acquis e BE dhe aktet e tjera të integritit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë.

Këto qëllime politikash janë afatgjata dhe shtrihen përgjatë kohës së zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit.

Realizueshmëria e objektivave specifike të katër qëllimeve të politikave të SND, në nivel objektiv

Realizueshmëria e qëllimit strategjik të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë, për këtë periudhë monitorimi është **90%**.

Qëllimi I	Realizueshmëria	Qëllimi II	Realizueshmëria	Qëllimi III	Realizueshmëria	Qëllimi IV	Realizueshmëria
1.1	139%	2.1	100%	3.1	100%	4.1	- ¹⁷
1.2	98%	2.2	100%	3.2	69%	4.2	100%
1.3	84%	2.3	74%	3.3	-	4.3	90%
		2.4	- ¹⁶	3.4	105%	4.4	100%
		2.5	160%	3.5	100%		

Numri i institucioneve të përfshira në procesin e zbatimit të Planit të Veprimit 2021 – 2025 është 26, ku ndër të tjera përfshihen institucione të sistemit të drejtësisë, institucione të nivelit qendror, institucione të pavarura, institucione varësie.

Rezulton se parashikimi i masave përgjatë viteve të zbatimit të planit të veprimit është pothuaj në raporte të njëjta për të katërta qëllimet. Ka një balancim të masave duke siguruar të njëjtën masë ndërveprimi dhe iniciativash institucionale dhe ndër-institucionale.

¹⁶ Nuk mund të matet për vitin 2021 pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton se të dhënat janë të padisponueshme. Pritet të analizohen muajin Prill 2022, në kuadrin e analizës vjetore të KLGJ.

¹⁷ Nuk mund të matet për vitin 2021, indikatorin fillon zbatueshmërinë në vitet në vijim.

Gjatë periudhës raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2021, janë monitoruar në total 16 objektiva specifik e 155 masa.


Qëllimi i Politikës	O.S dhe Masat	Realizimi i Masave dhe Masave për vitin 2021			
		O.S dhe masa të parashikuara për vitin 2021	O.S dhe masa plotësisht të realizuara	O.S dhe masa pjesërisht të realizuara ¹⁸	O.S dhe masa të porealizuara ¹⁹
Qëllimi i Parë	O.S	3	0	3	0
	Masa	22	13	6	3
Qëllimi i Dytë	O.S	5	0	4	1
	Masa	51	24	15	12
Qëllimi i Tretë	O.S	4	0	3	1
	Masa	46	13	24	9
Qëllimi i Katërt	O.S	4	0	2	2
	Masa	36	7	7	22
TOTAL	O.S	16	0	12	4
	Masa	155	57	52	46

Rezultoni se nga totali prej 16 objektiva specifik e 155 masash të parashikuara në planin e veprimit për periudhën *janar - dhjetor 2021*, statusi aktual i tyre për të katër qëllimet e politikave, është raportuar si më poshtë:

- 57 masa të realizuara;
- 12 objektiva e 52 masa ende në proces zbatimi;
- 4 objektiva e 46 masa të pazbatuara.

¹⁸ Masë "pjesërisht e realizuar" është ajo masë që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

¹⁹ Masë "e porealizuar" është ajo masë e cila është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.



Përsa më sipër, nga 57 masa **të realizuara** për janar-dhjetor 2021, konkretisht:

- 13 masa i përkasin qëllimit të parë të politikës;
- 24 masa i përkasin qëllimit të dytë të politikës;
- 13 masa i përkasin qëllimit të tretë të politikës;
- 7 masa përkasin qëllimit të katërt të politikës.

Nga 12 objektiva specifike e 52 masa të cilat janë ende **në proces zbatimi** për janar-dhjetor 2021, konkretisht:

- 3 objektiva specifike e 6 masa i përkasin qëllimit të parë të politikës;
- 4 objektiva specifike e 15 masa i përkasin qëllimit të dytë të politikës;
- 3 objektiva specifike dhe 24 masa i përkasin qëllimit të tretë të politikës;
- 7 objektiva specifike dhe 7 masa i përkasin qëllimit të katërt të politikës.

Nga 4 objektiva specifike e 46 masa **të parealizuar** për janar-dhjetor 2021, konkretisht:

- 3 masa i përkasin qëllimit të parë të politikës;
- 1 objektiv specifik dhe 12 masa i përkasin qëllimit të dytë të politikës;
- 1 objektiv specifik dhe 9 masa i përkasin qëllimit të tretë të politikës;
- 2 objektiva specifike dhe 22 masa i përkasin qëllimit të katërt të politikës.

2.2 Impakti i zhvillimit të sektorit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë

Reforma në sistemin e Drejtësisë në Shqipëri si prioritet i qeverisë në vitet e fundit, ka dhënë efektet e saj të dukshme duke përfshirë, ndër të tjera, ngritjen e një sistemi të plotë të verifikimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, krijimin e institucioneve të reja që drejtojnë gjyqësorin, krijimin e një prokurorie dhe gjykatash speciale për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe reformimi thelbësor i institucioneve ekzistuese, duke përfshirë Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Prokurorinë e Përgjithshme

Krahasuar me kandidatët kryesorë të zgjerimit të Ballkanit Perëndimor, në Shqipëri procesi kushtetues i riorganizimit të gjyqësorit përfundoi përpara fillimit të procesit të negociatave të anëtarësimit në BE. Fokusi tashmë është zhvendosur drejt funksionimit të duhur dhe efikasitetit të strukturave dhe institucioneve të sapokrijuara. Kushtëzimi i “frontloading” i ka lejuar Shqipërisë të shënojë një progres të rëndësishëm në shumë fusha të mbuluara nga Kapitulli 23.

2.3 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritit evropian

Procesi i integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE) është konsideruar si prioritet strategjik kombëtar nga shteti shqiptar, në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare, në përputhje me vlerat dhe parimet e Europës së Bashkuar. SND 2021-2025 synon të reflektojë standardet e parashikuara në Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Vizioni i SND 2021-2025 dhe qëllimet e politikës synojnë drejtpërdrejt rritjen e kapaciteteve institucionale për të udhëhequr procesin e përafrimit të legjislacionit me *acquis* e BE-së për këtë kapitull. Zbatimi në mënyrën e duhur të *acquis* në sistemin vendas përbën një ndër kushtet themelore për integrimin evropian të vendit.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023. Kapitulli 23 është një kapitull thelbësor në procesin e stabilizim-asociimit dhe mbart një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim. Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme: (1) *sistemin gjyqësor*; (2) *politikat kundër korrupsionit* dhe (3) *të drejtat themelore*. Përafrimi i parimeve me *acquis* e BE-së për kapitullin 23 përbën një detyrim që rrjedh nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri. Nenet 1, 2, 13, 70 dhe 78 të MSA-së bartin rëndësi thelbësore për këtë kapitull. Sipas nenit 78, “Fuqizimi i institucioneve dhe shtetit të së drejtës”, një rëndësi e veçantë duhet t’i kushtohet forcimit të institucioneve në të gjitha nivelet administratës në përgjithësi, forcimit të sundimit të ligjit dhe zbatimit të tij, si dhe administrimit të drejtësisë. Përveç kësaj, neni 78 i MSA-së përcakton se bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian duhet të synojë forcimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe përmirësimin e efektivitetit të tij, përmirësimin e funksionimit të organeve të policisë dhe të zbatimit të ligjit, duke siguruar trajnime të përshtatshme dhe duke luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Gjithashtu, përafrimi me *acquis* dhe standardet e BE-së për kapitullin 23 është një nga kërkesat që vendi kandidat në BE duhet të plotësojë gjatë procesit të negociatave për aderim në Bashkimin Evropian.

2.4 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Procesi i monitorimit të vazhdueshëm me baza gjashtë-mujore dhe vjetore që kryhet nga Ministria e Drejtësisë në kuadër të monitorimit të zbatueshmërisë të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë ndihmon në identifikimin e problematikave në realizimin e masave të parashikuara, me qëllim adresimin e tyre në mënyrën dhe kohën e duhur. Raportimi i çartë i këtyre problematikave, ndihmon në rritjen e vëmendjes ndaj komponentëve që kanë nevojë për përpjekjet të shtuara për të përmirësuar implementimin e më tej realizimin final. Kështu, bazuar në analizimin e kontributeve dhe raportimeve të institucioneve të përfshira në zbatimin e SND-së, elementët të cilët kanë nevojë për adresim dhe vëmendje të shtuar janë: O.S 1.2, 2.4, 3.4, 3.5, 4.1, 4.2.

Në këtë kuadër bazuar në analizimin e kontributeve dhe raportimeve të institucioneve të përfshira janë paraqitur më poshtë propozimet për vijueshmërinë e relizimit të tyre:

O.S. 1.2 Vijimi i përditësimit dhe përmirësimit të legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës.

O.S. 2.4 Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor.

O.S 3.4 Të vijohet konsolidimi i strukturës organike të Shërbimit të Provës për të mundësuar bashkëpunimin me institucionet përkatëse për të arritur realizueshmërinë e masave.

O.S 3.5 Të vijojë koordinimi dhe ndërveprimi operacional me institucionet e tjera për implementimin e masave.

O.S 4.1 Finalizimi i vendimmarrjes për ngritjen dhe funksionimin e QTI-së. Plotësimi i kapaciteteve njerëzore, teknike dhe financiare, si dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme me sisteme IT dhe sisteme të tjera mbështetëse për realizueshmërinë e veprimtarisë dhe masave të përcaktuara në Planin e Veprimit.

O.S 4.2 Të vijohet me organizimin e trajnimeve aftësuese me qëllim përmbushjen e nevojave për arritjen e objektivave të punës dhe detyrave funksionale të stafit të institucioneve përkatëse të cilat kanë detyrim zbatimin e mekanizmit IPSIS.

2.5 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Monitorimi i zbatimit të buxhetit të planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë është një element i rëndësishëm që mundëson analizimin e efektivitetit të progresit të strategjisë. Ky raport monitorimi synon të sigurojë transparencë për cdo palë të interesuar duke prezantuar shpenzimeve të kryera me qëllim marrjen e masave për të adresuar nevojat sa i përket burimeve

financiare.²⁰ Plani i detajuar i veprimit, bashkangjitur si aneks këtij dokumenti strategjik, është hartuar në përputhje me metodologjinë e sistemit IPSIS. Ai është kostuar dhe buxhetet e detajuara parashikohen në të njëjtën mënyrë në sistemin IPSIS, duke ofruar edhe ndarjen e duhur për programet buxhetore sipas institucioneve. Financat do të mbulohen nga buxheti i shtetit, kontrata sektorale “BE-ja për reformën në drejtësi”, nga donatorët në formën e granteve, kredive ose çdo fondi tjetër kapital apo asistencë teknike të parashikuar. Kostoja totale për zbatimin e Strategjisë parashikohet të jetë **4 154 621 209 lekë** ose **33 777 408 euro**. Masat e kostuara në planin e veprimit 2021-2025, **të cilat janë planifikuar të mbulohen nga fondet e buxhetit të shtetit**, janë brenda fondeve të caktuara për institucionet përgjegjëse, sipas VKM-së nr. 440, datë 22.07.2021, “Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”.


- Totali i buxhetit të përdorur për vitin 2021 është si më poshtë vijon:
 - Financimi nga buxheti i shtetit është në shumën 130, 941.000 lekë.
 - Financimi nga donatorët është në shumën 0 lekë.

Buxheti i përdorur sipas qëllimeve të politikës është:

- **Qëllimi i Parë i Politikës:** *funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane, duke garantuar pavarësinë, efektshmërinë dhe llogaridhënien.*

Kostoja totale për Qëllimin e Parë të Politikës për vitin 2021 është përcaktuar në vlerën 78,209,000 lekë. Buxheti i shpenzuar për ekzekutimin e masave të Qëllimit të Parë për vitin 2021 është përlllogaritur në vlerën 40,309,000 lekë. Buxheti i cili ishte parashikuar për tu shpenzuar në kuadër të qëllimit të parë të politikës për aktivitetet të cilat rezultojnë të përealizuara apo në proces zbatimit do të shpenzohen në realizimin e tyre në vijim.


²⁰ Vlen për tu theksuar se përgjatë dërgimit të kontributit është hasur mungesa e informacionit që lidhet me ekzekutimin e buxhetit.



Buxheti i shpenzuar për vitin 2021 rezulton në vlerën 40, 309.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit.

Qëllimi i Dytë i Politikës: *rritja e transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane.*

- Kostoja totale për Qëllimin e Dytë të Politikës për vitin 2021 është përcaktuar në vlerën 63,708,000 lekë. Buxheti i shpenzuar për ekzekutimin e masave të Qëllimit të Dytë të Politikës për vitin 2021 është përlogaritur në vlerën 62,428,000 lekë. Buxheti i planifikuar në kuadër të realizimit të masave të qëllimit të dytë të politikës është shpenzuar në vlerën më të madhe të tij nga institucionet përgjegjëse/bashkëpërgjegjëse, diferenca do të përdoret për zbatimin e mëtejshëm të masave të cilat rezultojnë të porealizuara/pjesërisht të realizuara.




Buxheti i shpenzuar për vitin 2021 rezulton në vlerën 62,428.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit.

Qëllimi i Tretë i Politikës: *një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, i cili garanton risocializimin, riintegrimin, rehabilitimin, respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar e me praktika solide të parandalimit të krimit.*

- Kostoja totale për Qëllimin e Tretë të Politikës për vitin 2021 është përcaktuar në vlerën 398,601,000 lekë. Buxheti i shpenzuar për ekzekutimin e masave të Qëllimit të Tretë të Politikës për vitin 2021 është përlogaritur në vlerën 19,743,000 lekë. Buxheti i parashikuar rezulton në vlerë të ulët të shpenzuar për shkak të porealizueshmërisë së masave të cilat lidhen drejtpërdrejtë me mirëfunksionim dhe organizimin e institucionit të Shërbimit të Provës, konkretisht masa 3.4.9 “Rritja e kapaciteteve të stafit për të siguruar një normë prej 50 stazhierësh për staf në përputhje me standartet evropiane dhe për të siguruar stafin e duhur për zyrat vendore, si dhe struktura e pagave u rishikua për të siguruar pagesën e duhur në të gjithë organizatën sipas aftësive dhe përgjegjësive në përputhje me skemën zyrtare të pagave” si dhe masa 3.4.7 “Dizenjimi dhe instalimi i teknologjisë së informacionit bashkëkohor si dhe sistemit të administrimit të çështjeve, duke krijuar lidhje me sistemin e integruar të drejtësisë elektronike”.


Buxheti i parashikuar për tu shpenzuar në kuadër të qëllimit të tretë të politikës për masat të cilat rezultojnë të porealizuara apo në proces zbatimi do të shpenzohen në periudhën në vijim.



Buxheti i shpenzuar për vitin 2021 rezulton në vlerën 19,743.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit.

Qëllimi i Katërt i Politikës: *koordinimi dhe menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjitha institucionet e sektorit.*

- Kostoja totale për Qëllimin e Katërt të Politikës për vitin 2021 është përcaktuar në vlerën 278,336,000 lekë. Buxheti i shpenzuar për ekzekutimin e masave të Qëllimit të Katërt të Politikës për vitin 2021 është përlogaritur në vlerën 8,461,000 lekë. Buxheti i parashikuar rezulton në vlerë të ulët të shpenzuar për shkak të porealizueshmërisë së masave të cilat lidhen drejtpërdrejtë me ngritjen, organizimin dhe mirëfunksionim e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, proces i cili është penguar si shkak i vonesave dhe mungesës së burimeve njerëzore.



Buxheti i parashikuar për tu shpenzuar në kuadër të qëllimit të katërt të politikës për masat të cilat rezultojnë të porealizuara apo në proces zbatimi do të shpenzohen në periudhën në vijim.

Buxheti i shpenzuar për vitin 2021 rezulton në vlerën 8, 461.000 lekë mbuluar nga buxheti i shtetit.

- Buxheti i përdorur sipas objektivave dhe burimi konkret i financimit është si vijon:

OS 1.1 : 217.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 1.2 : 5,348.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 1.3: 43,140.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 2.1 : 7,546.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 2.2 : 786.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 2.3 : 526.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 2.4 : 1,481.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 3.1: 6,504.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 3.2 : 0 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 3.4 : 3,721.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 3.5 : 9,518.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 4.1: 20.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 4.2: 2,305.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 4.3 : 4,163.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

OS 4.4: 1,973.000 lekë, mbuluar nga buxheti i shtetit.

Gjatë procesit të dërgimit të kontributit nga institucionet haset si problematikë raportimi i masave ku rezultojnë institucion përgjegjës në “kosto administrative” ndërkohë që është parashikuar buxhet për realizueshmërinë e tyre. Gjithashtu, mosraportimi i buxhetit mbi masat përkatëse sjell si pasojë mungesën e një vlere.

III. PROGRESI I LIDHUR ME QËLLIMET POLITIKE, OBJEKTIVAT SPECIFIKE DHE MASAT

Në vijim do të përshkruhet progresi i arritur në kuadër të përmbushjes së katër qëllimeve të politikës, objektivave dhe masave të Planit të Veprimit 2021-2025, për periudhën e monitorimit *I janar - 31 dhjetor 2021*.

Qëllimet e Politikave bëhen të realizueshëm nëpërmjet objektivave specifike në funksion të zbatimit të masave, të parashikuara për zbatim nga institucionet përgjegjëse edhe bashkëpërgjegjëse të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Në përputhje me SND, janë kryer masa dhe realizuar objektivat përkatës të parashikuara në Planin e Veprimit 2021 – 2025 për periudhën raportuese të lidhura me të 4 qëllimet e politikës.


- ✚ **QËLLIMI I PARË I POLITIKËS** - Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien.

Përmes **Qëllimit të Parë të Politikës** synohet që institucionet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë të funksionojnë plotësisht e në mënyrë profesionale, në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane, duke garantuar pavarësinë, efektshmërinë dhe llogaridhënien.

Ai lidhet me *objektivin 16 të zhvillimit të qëndrueshëm*, i cili promovon një shoqëri paqësore e gjithëpërfshirëse, garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ngritjen e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, ky qëllim lidhet me nënobjektivin 16.6, “*Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet*”, dhe 16.7, “*Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet*”. Gjithashtu, ky qëllim lidhet me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021-2023, bazuar edhe në rekomandimet e raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020 dhe prioritetet për kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar objektivat specifikë dhe kryer masat si më poshtë:

Qëllimi i Parë i Politikës	Objektivat dhe Masat	Realizimi i Masave			
		Objektiva Specifikë dhe masa të parashikuara për vitin 2021	Objektiva dhe masa plotësisht të realizuara	Objektiva dhe masa pjesërisht të realizuara ²¹	Objektiva dhe masa të porealizuara ²²
Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientë dhe llogaridhënie.	Objektiva Specifikë	3	0	3	0
	Masa	22	13	6	3



Rezulton se nga 3 objektiva specifikë dhe 22 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2021 – 2025, për janar-dhjetor 2021, për Qëllimin e Parë të Politikës janë realizuar:

- 13 masa;
- 3 objektiva specifik/6 masa janë ende në proces zbatimi;
- 3 masa janë të pazbatuara, përkatësisht masa:

²¹ Masë "pjesërisht e realizuar" është ajo masë që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.


²² Referuar metodologjisë Masë "e porealizuara" është ajo e cila është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind

- a) **1.2.7** “Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në, konsultimi dhe miratimi i akteve” *(Aktet janë në fazë konsultimi dhe pritet të miratohen së shpejti)*
- b) **1.3.2** “Përfundimi i procedurave të emërimit të inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë pranë ILD-së si dhe përfundimi i rekrutimeve të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” *(Mos kandidimi i magjistratëve gjyqtar në pozicionin e inspektorit magjistrat pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka sjellë si pasojë mungesa në burime njerëzore në njësinë e magjistratëve)*
- c) **1.3.5** “Përgatitja e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik të ILD për pajisjen me ambiente pune/logjistikë për të gjithë numrin e punonjësve të ILD-së” *(Risrukturimi i godinës aktuale sipas procedurave përkatëse do të vijojë në vitin pasardhës).*

Nga 7 treguesit e performancës për Qëllimin e Parë të Politikës rezulton se:

- për 3 tregues performance është arritur vlera e synuar;
- për 2 tregues performance është arritur pjesërisht vlera e synuar;
- si dhe për 2 tregues performance nuk është arritur vlera e synuar.

Qëllimi i Parë i Politikës	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht	Vlera e synuar nuk është e realizuar
	7	3	2	2



Indikator në nivel Qëllimi: % e subjekteve të rivlerësimit kalimtar që besojnë se institucionet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë janë të pavarura dhe të paanshme është parashikuar të realizohet në nivel të lartë ndikimi, pra në **nivel qëllimi**. Treguesi krijohet për herë të parë dhe vlerat e para do të jenë ato të vitit 2021. Vlera e synuar për treguesin e performancës për vitin 2021 është 40%.


Treguesi do të matë impaktin e institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë duke matur perceptimin e subjekteve të rivlerësimit në drejtim të pavarësisë dhe paansisë së këtyre institucioneve, nëpërmjet pyetësorit vjetor të hartuar nga KLGJ/KLP drejtuar subjekteve të rivlerësimit kalimtar. Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e realizimit të vlerës së synuar të këtij treguesi, rezulton se treguesi është arritur në masën **0%**.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve (shtojca 2 e Planit të Veprimit), paraqitet si vijon:

Vlera bazë	2020	Do të matet për herë të parë në vitin 2021
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	40%
	2021 (targeti i arritur)	0%
	2022	50%
	2023	65%

Vlera e synuar	2024	75%
	2025	90%

Realizueshmëria e këtij treguesi paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:



- **Objektivi Specifik 1.1** “Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit”.

Masat e parashikuara në planin e veprimit të SND 2021-2025 në lidhje me këtë objektiv specifik do të zbatohen për të arritur këto rezultate në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve i përfunduar për të tre kategoritë e subjekteve të rivlerësimit (gjyqtarë, prokurorë, këshilltarë dhe ndihmës ligjorë) si dhe shqyrtimi i ankimeve në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda afatit kushtetues dhe ligjor. Gjithashtu, rregullat përkatëse, praktikat e mira, njohuritë, kapacitetet dhe mësimet e marra janë transferuar në mënyrën e duhur në institucionet përkatëse të qeverisjes së sistemit të drejtësisë për vlerësime të qëndrueshme dhe të besueshme për gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë. Për vitet 2021-2025 janë parashikuar masat si më poshtë.

Plani i Veprimit për Objektivin 1.1 parashikon 5 masa.

1.1.1	Përgatitja dhe konsolidimi i raporteve të verifikimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit nga organet ekzistuese të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në mandatin ekzistues.
-------	--

1.1.2	Mbështetje ligjore dhe buxhetore për organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.
1.1.3	Finalizimi i raporteve të vlerësimit përfundimtar.
1.1.4	Rishikimi i kuadrit ligjor për organet e qeverisjes së drejtësisë dhe përfshirja e përvojave të mira në legjislacionin e rishikuar.
1.1.5	Rishikimi i rregulloreve të brendshme të organeve të qeverisjes në sistemin e drejtësisë dhe përfshirja e praktikave të mira në rregulloret e rishikuara.

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 1.1, ku më konkretisht përmendim:**

- Për vitin 2021 Komisioni i Pavarur të Kualifikimit ka patur si objektiv përmbylljen e 120 dosjeve. Rezulton se ky synim është tejkaluar pasi janë përfunduar 167 dosje.
- Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shpallur për periudhën Janar - Dhjetor 2021, 38 vendime duke vendosur: lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit - në 29 vendime; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare - në 1 vendim; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit - në 5 vendime; ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit - në 1 vendim; prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke urdhëruar Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë kryerjen e procesit të rivlerësimit - në 1 vendim; prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit - në 1 vendim. Sa i përket denoncimeve nga publiku, gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2021, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar dhe trajtuar 151 denoncime.

❖ **Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:**

- % e gjyqtarëve/prokurorëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar nga organet e sistemit të drejtësisë (vlera të ndara sipas shkallëve të gjyqësorit/prokurorisë)²³

Ky indikator do të tregojë gjatë gjithë viteve progresin në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Vlera bazë e treguesit është 85%. Vlera e synuar për **treguesin e performancës** për vitin 2021 mbi % e gjyqtarëve/prokurorëve që kanë përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar nga organet e sistemit të drejtësisë (vlera të ndara sipas shkallëve të gjyqësorit/prokurorisë) është 70 %.

²³ Target i vendosur do të jetë pjesë e analizës për vitet në vijim vetëm për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Raportimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit bazuar në organizimin dhe funksionim e tij do të konsistojë vetëm në të dhënat statistikore lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit si dhe koston në buxhet të aktivitetit të parashikuar për vitin përkatës.

Gjatë vitit 2021, vlera e synuar është tejkaluar duke arritur në 167 vendime. Konkretisht 98 gjyqtare, 61 prokurorë si dhe 8 të tjerë.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve paraqitet si vijon:

Vlera bazë	Viti 2020	85%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	70%
	2021 (targeti i arritur)	139%
	2022	75%
	2023	80%
	2024	90%
	2025	100%

Në mënyrë grafike realizueshmëria e këtij treguesi paraqitet si më poshtë:



Niveli i realizimit të Objektivit Specifik 1.1.²⁴

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.1 Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 **është 139%**.

Shkalla e realizimit të objektivit 1.1 për këtë periudhë raportimi është *tejkalar (111 dhe më lart e masave të realizuara)*.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për janar - dhjetor 2021.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.1

Në drejtim të realizimit të masave, risku qëndron në ritmet e procesit të rivlerësimit kalimtar mund të ulen, p.sh. për shkak të krizës së shkaktuar nga Covid-19 dhe mungesës së burimeve financiare. Ky objektivi ka mundësi të mesëm risku dhe ndikim të mesëm të tij.

- ❖ **Objektivi Specifik 1.2 “Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke**

²⁴ Objektivi Specifik 1.1 është i ndërlidhur vetëm me 1 tregues.

përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin e përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin”.

Masat e parashikuara në planin e veprimit të SND 2021-2025 në lidhje me këtë objektiv specifik do të zbatohen për të arritur këto rezultate konkrete në: struktura e qeverisjes së gjyqësorit (KLGJ) /legjislacioni i rishikuar/i ndryshuar, i përfshirë por pa u kufizuar në rregulloret e brendshme; struktura e qeverisjes së prokurorisë (KLP)/legjislacioni i rishikuar/i ndryshuar, përfshirë, por pa u kufizuar në, rregulloret e brendshme; strukturat e llogaridhënies (ILD, KLGJ dhe KLP)/legjislacioni i rishikuar/i ndryshuar, përfshirë, por pa u kufizuar në, rregulloret e brendshme.

Plani i veprimit për Objektivin 1.2 parashikon 12 masa si më poshtë:

1.2.1	Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLGJ-në.
1.2.2	Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të KLGJ-së (draftpropozimet ligjore).
1.2.3	Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLGJ-në, konsultimi dhe miratimi i akteve).
1.2.4	Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të KLGJ-së.
1.2.5	Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në.
1.2.6	Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të KLP-së (draftpropozimet ligjore).
1.2.7	Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në, konsultimi dhe miratimi i akteve).
1.2.8	Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të KLP-së.
1.2.9	Përgatitja e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me ILD-në.
1.2.10	Përgatitja e përgjigjes mbi analizën e rishikimit të ligjit mbi statusin dhe strukturën qeverisëse të ILD-së (draft-propozimet ligjore).
1.2.11	Rishikimi dhe konsolidimi i rregullave të brendshme të ILD-së.
1.2.12	Përgatitja e një plani operacional të ILD-së për trajtimin e ankesave te prapambetura.

❖ Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 1.1, ku më konkretisht përmendim:

- Këshili i Lartë Gjyqësor ka finalizuar rishikimin e kuadrit ligjor lidhur me qeverisjen e sistemit të drejtësisë duke vijuar me miratimin e draftpropozimeve në Kuvend në mars 2021. Është miratuar me Vendim të KLP nr. 407, datë 17.12.2021, "Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të KLP". Në kuadër të hartimit të projektligjit

për disa ndryshime në ligjin nr. 115/2016 “Për organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” (i ndryshuar), Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë vitit 2020 ka dërguar propozime për ndryshime ligjore.

❖ **Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:**

- *Numri i akteve nënligjore të miratuara në lidhje me kompetencat, efikasitetin dhe koordinimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (vlera të ndara për KLGJ/KLP/ILD).*
- *Numri i propozimeve për ndryshime ligjore të bëra nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.*

Vlera e synuar **për treguesin e performancës** “Numri i akteve nënligjore të miratuara në lidhje me kompetencat, efikasitetin dhe koordinimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (vlera të ndara për KLGJ/KLP/ILD)”, për vitin 2021 është: KLGJ 10 akte, KLP 3 akte, ILD 12 akte. Indikatori do të masë aktet ligjore të miratuara lidhur me përmiresimin e kompetencave, koordinimit dhe efikasitetit të organeve të drejtësisë.


Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për këtë periudhë monitorimi, konstatohet se treguesi është arritur në masën **84%** për vitin 2021.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlerat Bazë	2020	KLGJ: 11 akte KLP: 7 akte
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	KLGJ:10 akte KLP:3 akte ILD:12 akte
	2021 (targeti i arritur)	KLGJ:12 akte KLP:1 akt ILD:14 akte Treguesi është arritur në vlerën 84% .

Realizueshmëria e këtij treguesi paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:

Numri i akteve nënligjore të miratuara në lidhje me kompetencat, efikasitetin dhe koordinimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë (vlera të ndara për KLGJ/KLP/ILD)




Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “Numri i propozimeve për ndryshime ligjore të bëra nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” për vitin 2021 është: KLGJ 3 propozime, KLP 0 propozime, ILD 2 propozime. Vlera bazë është viti 2020, KLGJ 7 propozime, KLP 3 propozime, 2 propozime ILD.

Për këtë periudhë monitorimi, Numri i propozimeve për ndryshime ligjore të realizuara nga organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë është 6: KLP 0, KLGJ ka bërë një numër propozimesh për amendimin e katër ligjeve: 96/2016, 98/2016, 115/2016 dhe 8577 datë 10.2.2000, ILD gjatë vitit 2021, nevoja për ndryshimet ligjore u bë pjesë e raportit të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore si një nga problematikat e hasura të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Vlerat Bazë	2020	KLGJ: 7 propozime KLP: 3 propozime ILD: 2 propozime
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	KLGJ: 3 propozime KLP: 0 propozime ILD: 2 propozime
	2021 (targeti i arritur)	KLGJ: 4 propozime KLP: 0 propozime ILD: 2 propozime Treguesi është arritur në vlerën 111%.

Realizueshmëria e këtij treguesi paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:



Niveli i realizimit të objektivit specifik 1.2.

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.2. Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin e përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 është 98%.*

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ O.S\ 1.2 = \frac{TP\ 1\ (84\%) + TP\ 2\ (111\%)}{2\ TP} \times 100\% = 98\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit 1.2 për këtë periudhë raportimi është **shumë mirë (86-110 e masave të realizuara)**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara janë bazuar në informacionin e raportuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë. (Raportet e KLGJ-së, KLP-së, ILD-së.)

Risqet për realizimin e Objektivit 1.2

Në drejtim të realizimit të Objektivit Specifik 1.2 risku ka mundësi “të mesëm” të ndodhjes dhe ndikim “të ulët”. Risqet lidhen kryesisht me vonesat në miratimin e propozimeve për ndryshime të akteve ligjore, të propozuara nga institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë.

❖ **Objektivi Specifik 1.3 “Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse”**

Plani i veprimit për Objektivin 1.3 parashikon 5 masa.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2021-2025 janë parashikuar masat (5) si më poshtë.

1.3.1	Përfundimi i procedurave të emërimit, promovimit, transferimit të magjistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës.
1.3.2	Përfundimi i procedurave të emërimit të inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë pranë ILD-së si dhe përfundimi i rekrutimeve të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
1.3.3	Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të inspektorëve të drejtësisë nëpërmjet trajnimeve specifike për pozicionet e punës.
1.3.4	Përgatitja e raporteve të analizës së grupeve të punës për evidentimin dhe kategorizimin e ankesave të mbartura nga institucionet e tjera, sipas objektit.
1.3.5	Përgatitja e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik të ILD për pajisjen me ambiente pune/logjistikë për të gjithë numrin e punonjësve të ILD-së.

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 1.1, ku më konkretisht përmendim:**

- Janë kryer procedurat përkatëse mbi ngritjen në detyrë të 12 prokurorëve në pozicion drejtuesi (promovim), dhe 24 prokurorëve me transferim nëpërmjet lëvizjes paralele. Nuk ka patur të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës për vitin akademik 2020-2021 (profili prokuror), prandaj nuk ka prokurorë të rinj të emëruar për vitin 2021.
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ka treguar një vëmendje të veçantë, lidhur me rritjen e kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke i dhënë prioritet zhvillimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë dhe kombëtarë që nga krijimi i institucionit. Zhvillimi i këtyre trajnimeve, shihet si një element shumë i rëndësishëm për rritjen e performancës jo vetëm të njësisë së inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve por të të gjithë stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Konkretisht Zyra e Inspektorit të Lartë

të Drejtësisë, për trajnimin e njësisë së inspektorëve deri tani ka patur bashkëpunime me organizata të huaja si Taiex, Opdat, Cepej, Misioni Euralius V..etj, dhe me ASPA-n. Me partnerë të huaj janë kryer 9 trajnime gjatë vitit 2021.

❖ **Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:**

- % e buxhetit të shtetit dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë
- % e procedurave të filluara disiplinore për ankesat kundër gjyqtarëve ose prokurorëve
- Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për disiplinën e ankesave të paraqitura në ILD.


Vlera e synuar për vitin 2021 për **treguesin e performancës** “- % e buxhetit të shtetit dedikuar organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, për vitin 2021 është: **KLJGJ** 0.083% e buxhetit të shtetit, **KLP** 0.045% e buxhetit të shtetit, **ILD** 0.08% e buxhetit të shtetit. Metodologjia e ndjekur apo që do të ndiqet në vazhdim për matjen e këtij treguesi ka si qëllim të tregojë përqindjen e buxhetit të shtetit që i dedikohet çdo vit organeve të sistemit të qeverisjes së drejtësisë. Vlera bazë është **KLJGJ**: 0.086%, **KLP**:0.028 %, **ILD**: 0.018%.

Gjatë vitit 2021, rezulton se **KLP** 0.045% e buxhetit, **KLJGJ** 0.09% e buxhetit të shtetit dhe **ILD** 0.07% e buxhetit. Për vitin 2021 treguesi është arritur në vlerën 99 %.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Viti	2020	KLJGJ: 0.086% KLP: 0.028 % ILD: 0.018 %
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	21/ILD 0.08% 21/KLJGJ: 0.083% 21/KLP 0.045%
	2021 (targeti i arritur)	KLP 0.045% KLJGJ 0.09% ILD 0.07%
	2022	ILD 0.06% KLJGJ: 0.089% KLP 0.045% e

Realizueshmëria e këtij treguesi në formë grafike paraqitet si më poshtë:



Vlera e synuar për treguesin e performancës “% e procedurave të filluara disiplinore për ankesat kundër gjyqtarëve ose prokurorëve” për vitin 2021 është 100 % (ILD do të nisë kërkesat për procedim disiplinor pranë këshillave përkatës, në çdo rast që do të konstatohen shkelje nga ana e magistratëve), e njëjta procedurë do të përsëritet për vitet 2022, 2023, 2024, 2025.


Për janar-dhjetor 2021, rezulton 17 kërkesa për procedime disiplinore pranë KLGJ-së dhe KLP-së.

Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e vlerës së synuar të këtij treguesi rezulton se treguesi është i realizuar në masën 100%.

Vlerat Bazë	*2020 Duke qënë së Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vetëm 1 vit që funksionon, si vlerë bazë ku duhet të evidentohet viti më i suksesshëm në kuadër të kërkesave për fillimet e procedimeve disiplinore mund t’i referohemi vetëm vitit 2020. Gjatë këtij viti, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nga 9 vendime për fillimin e hetimit disiplinor janë drejtuar 4 (katër) kërkesa për procedim disiplinor pranë Këshillave nga të cilat: 3 (tre) kërkesa drejtuar KLGJ dhe 1 (një) kërkesë drejtuar KLP, 3(tre) kërkesat e depozituara pranë KLGJ janë pranuar dhe 1 (një) kërkesë drejtuar KLP është rrëzuar. (në përqindje rezulton: 44% e numrit të vendimeve për fillimin e hetimit disiplinor kanë rezultuar të përfundojnë me kërkesa për procedim disiplinor pranë Këshillave përkatës.)	
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	Ky tregues nuk mund të jetë i matshëm, pasi lidhet ngushtë me procesin e trajtimit të ankesës, pra me objektin e ankesës, dhe si rrjedhojë nuk mund të parashikohet se në sa prej ankesave të cilat do të shqyrtohen gjatë vitit 2021 do

		të vlerësohet nëse ka rast për fillimin e procedimit disiplinor apo jo.
	2021 (targeti i arritur)	17 kërkesa për procedime disiplinore 100 %

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike, paraqitet si më poshtë:



Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “Treguesi i zgjidhjes së çështjeve të prapambetura për disiplinën e ankesave të paraqitura në ILD” për vitin 2021: Vlera bazë do të referohet vitit 2021 pasi edhe numri i inspektorëve është më i lartë, 8 kundrejt 1, që është gjatë vitit 2020. Për periudhën janar-qershor 2021 numri i ankesave të baclogut të trajtuara është 297 ankesa. Në përqindje llogaritet: $297/2104*100= 14.1\%$ ankesa të trajtuara nga backlog për periudhën janar-qershor 2021. Për rrjedhojë duke ndjekur këtë trend, **vlera e synuar gjatë vitit 2021 do të jetë përafërsht 700 ankesa të trajtuara nga backlog-u.**


Gjatë vitit 2021 rezulton se janë trajtuar 387 ankesa që i përkatesin backlog. Në këto kushte, vlerësohet se ky tregues performance është arritur në masën **55%**.

Realizueshmëria e treguesit paraqitet si më poshtë vijon:

Vlerat Bazë		Vlera bazë do të referohet vitit 2021 pasi edhe numri i inspektorëve është më i lartë, 8 kundrejt 1, që është gjatë vitit 2020. Për periudhën janar-qershor 2021 numri i ankesave të baclogut të
--------------------	--	--

	2020	trajtuara është 297 ankesa. Në përqindje llogaritet: $297/2104*100= 14.1\%$ ankesa të trajtuara nga backlog për periudhen janar-qershor 2021. Për rrjedhoje duke ndjekur këtë trend, vlera e synuar gjatë vitit 2021 do të jetë përafërshtit 700 ankesa të trajtuara nga backlog-u.
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	Vlera e synuar gjatë vitit 2021 do të jetë përafërshtit 700 ankesa të trajtuara nga backlog-u.
	2021 (targeti i arritur)	Rezulton të jenë trajtuar në total, 387 ankesa që i perkatesin backlog. Realizuar 55 %

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit në mënyrë grafike, paraqitet si vijon:



Niveli i realizimit të objektivit 1.3

Niveli i realizimit të *Objektivit 1.3 Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit*

të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **84%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 1.3 = \frac{TP\ 99\% + TP\ 100\% + TP\ 55\%}{3\ TP} \times 100\% = 84\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit 1.3 për këtë periudhë raportimi është **84% mirë (51 në 85 për qind e masave të realizuara)**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara janë bazuar në informacionin e raportuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Risqet për realizimin e Objektivit 1.3

Risku i realizimit të këtij objektivit është i nivelit të mesëm për shkak të faktorëve të lidhura me organizimin dhe funksionimin e procedurave të emërimit, promovimit, transferimit të magjistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës. Pra, ka mundësi të mesme të ndodhjes dhe ndikim të mesëm të tij.

Realizueshmëria e objektivave specifike të Qëllimit të Parë të Politikës

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 3 objektivave specifike të qëllimit të parë të politikës.

Realizueshmëria e Qëllimit të Parë të Politikës është 81%.²⁵

Objektivi Specifik	Realizueshmëria
1.1 Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit.	139%
1.2 Përditësimi dhe përmirësimi i legjislacionit të reformës në drejtësi bazuar në gjetjet nga analiza dhe monitorimi i zbatimit të reformës, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, legjislacionin e përditësuar për kompetencat, transparencën, efikasitetin, dhe koordinimin.	98%

²⁵ Përlllogaritur së bashku me indikatorin në nivel qëllimi.

1.3 Fuqizimi dhe konsolidimi i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me standardet Evropiane, nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, që të kryejnë aktivitetin me pavarësi, efikasitet dhe standarde profesionale, dhe ofrimi i shërbimit të institucioneve të qeverisjes në drejtësi përmbush rregullat dhe standardet përkatëse.	84%
--	-----

✚ QËLLIMI I DYTË I POLITIKËS “Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane”.

Përmes **qëllimit të dytë** të politikës synohet rritja e transparencës, aftësisë profesionale, aksesueshmërisë dhe efikasitetit të gjyqësorit në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet evropiane. Ai lidhet me objektivin 16 të *objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG)*, i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse, garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ngritjen e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Në veçanti, ky qëllim politik lidhet me nënobjektivat 16.3, “*Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë*”, 16.6. “*Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet*”, dhe 16.7, “*Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet*”.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masa sipas tabelës më poshtë.


Qëllimi i Dytë i Politikës	Objektivat Specifikë dhe Masat	Realizimi i Masave			
		Os dhe masa të parashikuara për vitin 2021	Os dhe masa plotësisht të realizuara	Os dhe masa pjesërisht të realizuara ²⁶	Os dhe masa të porealizuara ²⁷
Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane	Objektiva Specifikë	5	0	4	1
	Masa	51	24	15	12

²⁶ Masë “pjesërisht e realizuar” është ajo masë që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

²⁷ Masë “e porealizuar” është ajo e cila është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind.

Rezulton se nga 5 objektiva specifike dhe 51 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2021 – 2025, për janar-dhjetor 2021, për Qëllimin e Dytë të Politikës rezulton se:

- 24 masa plotësisht të realizuara;
- 4 objektiva dhe 15 masa pjesërisht të realizuara;
- 1 objektivi dhe 12 masa të porealizuara.



Nga 7 treguesit e performances për Qëllimin e Dytë të Politikës:


- për 6 tregues performance është arritur vlera e synuar;
- për 1 tregues performance është arritur pjesërisht vlera e synuar.

Qëllimi i Dytë i Politikës	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ²⁸	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ²⁹	Vlera e synuar nuk është e realizuar ³⁰
	7	6	1	0

²⁸ Që është realizuar në shkallën 100 për qind

²⁹ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

³⁰ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mbledhen të dhëna



- ❖ ***Objektivi Specifik 2.1: “Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe efijencën”.***

Plani i veprimit për Objektivin 2.1 parashikon 13 masa.

2.1.1	Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të Kodi i Procedurës Civile (KPC).
2.1.2	Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të KPC-së.
2.1.3	Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të KPC-së të ndryshuar.
2.1.4	Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes (KF).
2.1.5	Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes (KF).
2.1.6	Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të KF-së të ndryshuar.
2.1.7	Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”.
2.1.8	Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”.
2.1.9	Kryerja e analizës së rishikimit të funksionimit dhe zbatimit të ligjit “Për gjykatat administrative dhe mosmarrëveshjet administrative”, të ndryshuar.

2.1.10	Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të akteve nënligjore në lidhje me sistemin gjyqësor (udhëzime/urdhëra) dhe rregullave standarde për funksionimin e gjykatave.
2.1.11	Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së akteve rregullatore për funksionimin e gjykatave.
2.1.12	Kryerja e analizës të zbatimit të akteve rregullatore për funksionimin e gjykatave.
2.1.13	Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së akteve nënligjore mbi nëpunësit civilë gjyqësorë.

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 2.1, ku më konkretisht përmendim:**

- Me një përfshirje ndërinstucionale, konkretisht me përfaqësues të sistemit të drejtësisë (KLP, KLGJ, ILD, GJL, PP), nën kryesimin e Ministrisë së Drejtësisë, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e misionit të asistencës teknike Misioni EURALIUS është realizuar analiza e vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim të analizës së kryer, është përgatitur projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në Kodin e Procedurës Civile, si dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues. Projektligji ka ndjekur të gjitha fazat e konsultimit dhe të shqyrtimit në Kuvend dhe është miratuar me ligjin nr. 44/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare të datës 14.5.2021.
- Është përgatitur projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 të ndryshuar, si dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues. Projektligji ka ndjekur të gjitha fazat e konsultimit dhe të shqyrtimit në Kuvend dhe është miratuar me ligjin nr. 49/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare të datës 14.5.2021. Nisma në fjalë, që prej fillimit të saj, është hartuar nga ekspertë të nivelit të lartë të drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe partnerët e Misionit EURALIUS dhe OPDAT. Këto ndryshime ligjore janë depozituar nga deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
- Në kuadër të përgatitjes, diskutimit dhe miratimit të paketës së ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes (KF) pas përfundimit të analizës së nevojshme për kryerjen e ndryshimeve në Kod, do të vijohet me përgatitjen e praktikës përkatëse dhe diskutimin e saj përmes konsultimit publik.

❖ **Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:**

- *% e akteve ligjore dhe nënligjore që i janë nënshtruar analizës së vlerësimit nga organet e gjyqësore.*

Indikatori - % e akteve ligjore dhe nënligjore që i janë nënshtruar analizës së vlerësimit nga organet e gjyqësore.


Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e akteve ligjore dhe nënligjore që i janë nënshtruar analizës së vlerësimit nga organet e gjyqësore.” për vitin 2021 është 100%. Qëllimi i këtij indikator është të masë numrin e të gjithë akteve ligjore që KLGJ ka analizuar gjatë një viti më qëllim përmirësimin e aftësive profesionale, aksesueshmërisë, transparencës dhe efencës së organeve gjyqësore.

Për këtë periudhë raportimi, *janar – dhjetor 2021*, KLGJ ka kryer 19 analiza vlerësimi. Për vitin 2021 është realizuar 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

Vlera Bazë	2020	100%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	100%
	2021 (targeti i arritur)	Realizueshmëria 100%

Realizueshmëria e këtij treguesi paraqitet në grafikun më poshtë:



Shkalla e realizimit të objektivit specifik 1.2 për këtë periudhë raportimi është **100% shumë mirë** (Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.1

Risku për të realizuar këtë objektiv specifik është i nivelit të mesëm për shkak të faktorëve të lidhura me burimet njerëzore dhe organizimin e brendshëm të institucionit, pra ka mundësi të mesme të ndodhjes dhe ndikim të mesëm të tij.

- ❖ **Objektivi Specifik 2.2** *“Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesional, në mënyrë transparente dhe efektive”.*

Plani i veprimit për Objektivin 2.2 parashikon 6 masa, ndër të cilat masa 2.2.2. nuk është marrë në analizë pasi e fillon zbatueshmërinë e tij në vitin 2022³¹.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2021-2025 janë parashikuar masat si më poshtë.

2.2.1	Kryerja e analizës mbi vendet vakante në GJK, hapja e thirrjeve dhe plotësimi i vakancave.
2.2.3	Përmirësimi infrastrukturor / logjistik i Gjykatës Kushtetuese bazuar në gjetjet e analizës.
2.2.4	Kryerja e një studimi dhe specifikimi i kërkesave të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me teknologjinë e informacionit, duke përfshirë regjistrin online dhe menaxhimin e çështjeve, arkivimin elektronik, nevojën për staf të specializuar etj.
2.2.5	Blerja e hardëare-it dhe softëare-it për Gjykatën Kushtetuese.
2.2.6	Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve.

- ❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 2.2, ku më konkretisht përmendim:**

- Gjykata Kushtetuese me vendimet nr. 41, datë 22.12.2021 dhe vendimin nr. 42, datë 22.12.2021 Gjykata Kushtetuese ka deklaruar mbarimin e mandatit kushtetues për gjyqtarët Altin Binaj dhe Përparim Kalo i cili u emërua në këtë gjykatë, në plotësim të vakancës së parakohshme të shkaktuar nga largimi i parakohshëm nga detyra të ish-gjyqarit z. Besnik Imeraj. Këto vendime i janë njoftuar Kuvendit dhe Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

³¹ Masa 2.2.2 fillon zbatueshmërinë pas vitit 2021

- Është rinovuar tërësisht rrjeti informatik i gjykatës, duke siguruar software-et dhe hardware-et e planifikuara.

❖ **Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:**

- % e numrit të akteve rregullatore që ka miratuar Gjykata Kushtetuese në zbatim të ligjit të saj
- Raporti i çështjeve të mbartura nga Gjykata Kushtetuese (%)

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e numrit të akteve rregullatore që ka miratuar Gjykata Kushtetuese në zbatim të ligjit të saj” për vitin 2021 është miratimi i dy akteve rregulltare nga Gjykata Kushtetuese në zbatim të ligjit të saj.

Vlera e synuar për indikatorin “% e numrit të akteve rregullatore që ka miratuar Gjykata Kushtetuese në zbatim të ligjit të saj”: miratimi 2 akteve. Ky indikator ka si synim matjen e numrit të akteve të analizuara dhe miratuar nga GJK në një vit në zbatim të ligjit të saj.

Gjatë periudhës 2021 **Gjykata Kushtetuese ka miratuar 2 akte:**


- 1- Miratuar Plani strategjik për veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese;
- 2- Miratuar Rregullorja “Për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese”.

Për vitin 2021 indikatorin është arritur në masën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë është si më poshtë vijon:

Vlera bazë	2020	
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	2 akte
	2021 (targeti i arritur)	2 akte të miratuara për vitin 2021, Realizuar 100%
	2022	0
Vlera e synuar/Targeti	2023	1

Realizueshmëria e këtij treguesi në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:




Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “Raporti i çështjeve të mbartura nga Gjykata Kushtetuese (%)” për vitin 2021 është 0.5%. Vlera bazë është viti 2020 vlera 0.68%.

Gjatë vitit 2021 Gjykata Kushtetuese është shprehur me 201 vendime, që ju përkasin kërkesave të mbartura nga vitet 2017; 2018; 2019; 2020 si dhe kërkesave të regjistruara gjatë vitit 2021. Rezultojnë të mbartura mbartura 36 çështje. Sipas të dhenave të Drejtorisë Gjyqesore dhe të Dokumentacionit të Gjykatës Kushtetuese, në vitin 2021 janë regjistruar në total 160 kërkesa.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera bazë	2020	0.68%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	0.5 %
	2021 (targeti i arritur)	0.5%
	2022	0.05%
Vlera e synuar/Targeti	2023	0.04%

Realizueshmëria e treguesit në menyre grafike paraqitet si më poshtë vijon:



Niveli i realizimit të objektivit 2.2

Niveli i realizimit të *Objektivit 2.2. Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesional, në mënyrë transparente dhe efektive* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **100 %**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 2.2 = \frac{TP\ (100\%) + TP\ (100\%)}{2\ TP} \times 100\% = 100\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit 2.2 për këtë periudhë raportimi 100% **shumë mirë (86-110 për qind e masave të realizuara)**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Gjykata Kushtetuese, të dhëna të Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit të Gjykatës Kushtetuese.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.2

Risku për të realizuar këtë objektiv është i nivelit të mesëm, pasi ka mundësi të lartë të ndodhjes dhe ndikim të mesëm të tij. Problemet e evidentuara lidhen me kapacitetin institucional dhe

financiar të Gjykatës Kushtetuese për të mundësuar infrastrukturën e nevojshme dhe logjistike për mirëfunksionimin e saj.

- ❖ ***Objektivi Specifik 2.3. “Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke siguruar një numër të përshatshëm të magistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri”.***

Plani i veprimit për Objektivin 2.3 parashikon 15 masa, nga të cilat 3 janë parashikuar për të filluar zbatueshmërinë e tyre pas vitit 2021³².

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitin 2021 janë parashikuar masat si më poshtë:

2.3.1	Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë për vlerësimin e nevojave për trajnim me standardet evropiane.
2.3.2	Përgatitja e metodologjisë së re për vlerësimin e nevojave për trajnim bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë.
2.3.4	Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë për vlerësimin e trajnerëve me standardet evropiane.
2.3.5	Përgatitja e metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë.
2.3.6	Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për vlerësimin e trajnerëve.
2.3.7	Kryerja e analizës së përputhshmërisë së metodologjisë së trajnimit të vazhdueshëm me standardet evropiane.
2.3.8	Përgatitja dhe unifikimi i metodologjisë së re për trajnimin e vazhdueshëm bazuar në rezultatet e analizës së përputhshmërisë.
2.3.9	Përgatitja, publikimi dhe shpërndarja e raporteve të monitorimit të zbatimit të metodologjisë së re për trajnimin vazhdues.
2.3.10	Kryerja e analizës për nevojën për rishikim të programeve të trajnimit vazhdues.
2.3.12	Kryerja e analizës së vlerësimit të ndryshimeve të nevojshme të ligjit “Për Shkollën e Magjistraturës në Republikën e Shqipërisë” dhe rregulloret e saj.
2.3.14	Përgatitja dhe miratimi i metodologjisë së studimeve dhe botimeve të Shkollës së Magjistraturës në përputhje me standardet evropiane.
2.3.15	Krijimi i bazës së të dhënave të lektorëve dhe trajnerëve të Shkollës së Magjistraturës, që kanë njohuri mbi ligjin e BE-së.

- ❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 2.3, ku më konkretisht përmendim:**

- Në kuadër të rritjes së efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke

³² Mast 2.3.3, 2.3.11, 2.3.13 janë parashikuar për të filluar zbatueshmërinë e tyre pas vitit 2021.

siguruar një numër të përshtatshëm të magistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri, Shkolla e Magjistraturës ndërroi një proces të gjatë analize të metodologjisë të trajnimeve, përfshirë procesin e analizës së nevojave dhe atë të realizimit të aktiviteteve trajnuese. Metodologjia e EJTN ishte një ndër mjetet krahasimore që u morr në konsideratë për të reflektuar mbi modelet e dakordësuara mes shkollave evropiane homologe.

- Përgatitja për Programin e Formimit Vazhdues ka nisur me analizën e nevojave për trajnim, proces i koordinuar nga Drejtori i Shkollës në bashkëpunim me Pedagogun Përgjegjës të Programit të Formimit Vazhdues dhe stafin e brendshëm pedagogjik. Përmes kryetarëve të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të apelit, si dhe të prokurorëve të rretheve gjyqësore dhe të apelit u koordinua marrja e nevojave dhe kërkesave për tematikat e Programit të Formimit Vazhdues të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend. Programi dhe kalendari u hartuan me kujdes, duke respektuar një metodologji eficiente dhe bashkëkohore, duke ndërthur mënyra të ndryshme marrje të informacionit dhe nevojave të sistemit. Prioriteti kryesor i ShM ka qënë cilësia e ofrimit të trajnimeve dhe vlerësimi i trajnimeve, si nga këndvështrimi i ekspertëve, edhe nga i pjesëmarrësve. Trajnerët janë përzgjedhur mbi bazë merite dhe në transparencë të plotë, duke i dhënë përparësi rritjes së përfshirjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si edhe ndjekjes me kujdes të procesit për përgatitjen e kurikulave dhe të moduleve të trajnimit prej trajnuesve. Për më tepër, i është dhënë rëndësi kualifikimit të stafit të ekspertëve trajnues (ose pedagogjik) për seminare të cilat janë krejt të reja për nga tematika, ose të tilla që janë organizuar deri tani nga Shkolla, por pjesërisht janë mbështetur edhe nga ekspertë të ardhur prej partnerëve ndërkombëtarë.
- Shkolla e Magjistraturës shpalli thirrjen për të shprehur interesin për ekspertë, specialistë të fushës dhe lehtësues, sipas Projekt Programit Tematik të Programit të Formimit Vazhdues për vitin akademik 2021-2022 duke aplikuar nëpërmjet dërgimit të dokumentacionit të kërkuar bazuar në Aneksin 11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu, është krijuar databaza e të dhënave të lektorëve dhe trajnerëve të Shkollës së Magjistraturës, që kanë njohuri mbi ligjin e BE-së. Është kryer identifikimi nga pikëpamja sasiore të numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që do të trajnohen lidhur me legjislacionin dhe standardet e BE-së dhe praktikën ndërkombëtare. Në këtë vështrim, studiohet një orientim i tematikës mbi bazë nivelesh dhe duke studiuar realitetin dhe perspektivën e përcimit të këtyre standardeve.

❖ **Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:**

- Kuotat Vjetore të kandidatëve magistratë, këshilltarëve dhe ndihmësve në Shkollën e Magjistraturës


Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “*Kuotat Vjetore të kandidatëve magistratë, këshilltarëve dhe ndihmësve në Shkollën e Magjistraturës*” për vitin 2021 është: KLGJ 100

kandidatë, KLP 25 kandidatë. Vlera bazë KLGJ 80, KLP 35. Ky indikator ka si synim matjen e numrit të magistratëve të pranuar në një vit. Gjatë vitit 2021, KLP³³ ka pranuar 23 magistratë, KLGJ ka pranuar 55 (35 magistratë dhe 20 keshilltare dhe ndihmes ligjore - vendimi nr. 35 date 28.01.2021). Indikatori për vitin 2021 është arritur 74%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit paraqitet si vijon:

Vlera Bazë	2020	KLGJ 80 KLP 35
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	KLGJ 100 magistratë të pranuar për një vit KLP 25 magistratë të pranuar për një vit
	2021 (targeti i arritur)	KLGJ 55 KLP 23 74%

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:



³³ 1 kandidat u ndalua me Vendim të KLP për t'u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin 2021-2022, ndërsa 1 kandidat u tërhoq nga Kandidimi

Niveli i realizimit të objektivit 2.3

Niveli i realizimit të Objektivit 2.3 për periudhën janar-dhjetor 2021 është 74 %. Shkalla e realizimit të objektivit 2.3 për këtë periudhë raportimi është **mirë** (*Nga 51 në 85 për qind e masave të realizuara*)

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.3

Risku për të realizuar këtë objektiv është i ulët, pasi nuk paraqet risk evident.

- ❖ ***Objektivi Specifik 2.4 Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.***

Plani i veprimit për Objektivin 2.4 parashikon 9 masa, nga të cilat një prej tyre do të fillojë zbatueshmërinë pas vitit 2021³⁴.

2.4.1	Përgatitja dhe miratimi i studimeve të fizibilitetit të infrastrukturës së gjykatave.
2.4.2	Kryerja e vlerësimeve të qëndrueshme, të pavarura dhe gjithëpërfshirëse të gjykatave, për të matur performancën kundrejt standardeve të përcaktuara.
2.4.3	Kryerja e analizës mbi nivelin e zbatimit të standardeve, kodit të etikës dhe raportimi publik mbi gjetjet.
2.4.4	Miratimi dhe zbatimi i hartes së re gjyqësore.
2.4.6	Kryerja e analizës dhe përgatitja e raporteve të monitorimit mbi zbatimin e dokumenteve strategjike të komunikimit nga KLGJ-ja.
2.4.7	Ëorkshop/tryeza teknike periodike me titullarët e institucioneve (KLGJ/KLP/PP), për rritje të bashkëpunimit ndërinstytucional.
2.4.8	Krijimi i infrastrukturës për të ngritur një njësi për pritjen e publikut pranë ILD-së.
2.4.9	Ngritja e kapaciteteve të ILD-së për ofrimin e ndihmës/këshillime me publikun për plotësimin e formularit të ankesave.

- ❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 2.4, ku më konkretisht përmendim:**

- Referuar ngritjes së kapaciteteve, të Sektorit të Ndihmës Juridike dhe Ankesave, si strukturë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, që pret dhe ndihmon në plotësimin

³⁴ Masa 2.4.5 do të fillojë zbatueshmërinë e tij pas vitit 2021.

e formularit TIP të ankesës cdo ditë të javës nga ora 09.00-14.00, ka ndjekur një sërë trajnimesh të organizuara nga ASPA, ku përmendim:

- 1- “Sjellja organizative në administratën publike”;
 - 2- “Komunikimi efektiv me median”;
 - 3- “Mbrojtja e të drejtave të njeriut”;
 - 4- “Edukimi ligjor i nëpunësve publike mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta e informimit në kuadër të ndihmës juridike”
 - 5- “Pjesëmarrja dhe konsultimi publik” etj.
- Në kuadër të hartimit dhe konsolidimit të dokumentit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 21-25, Ministria e Drejtësisë vlerësoi se përfshirja e institucioneve të reja të drejtësisë do të ndikonte në rritjen e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe për të qenë të angazhuar në çdo proces vendimarrës në përgjithësi si dhe në veçanti atë të Reformës në Drejtësi. Draft-dokumenti strategjik është diskutuar në mbledhje të Komitetit Drejtues Sektoral për Reformën në Drejtësi, përkatësisht në 21 Janar dhe 24 Maj 2021 si dhe në kuadër të përmbylljes së procesit të hartimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për vitet 2021-2025 më datën 23 Korrik 2021, u realizua Tryeza “5 vjet nga Reforma në Drejtësi: Konsolidimi i sistemit përmes Strategjisë së re Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025” me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe me një sërë institucioneve të tjera ku u miratua ne parim paketa strategjike.
 - Projekt propozimi i Hartës së Re Gjyqësore, i dakordësuar me Ministrin e Drejtësisë, u lancua në 28 Dhjetor 2021. Aktualisht, KLGJ në bashkëpunim me MD kanë ndërmarrë një fushatë konsultimi publik të projekt propozimit me grupet e interesit nëpër gjithë territorin e vendit.

❖ **Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:**

- *% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të një çështje penale (vlera të ndara për shkallën e parë dhe shkallën e apelit, vetëm juridiksion i zakonshëm)*
- *% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të çështjes civile në shkallën e parë dhe në apel (vlera të ndara për secilin nivel)*
- *% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar.*

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të një çështje penale (vlera të ndara për shkallën e parë dhe shkallën e apelit, vetëm juridiksion i zakonshëm)” për vitin 2021 është: *Klgj, DT penale sh1 =70 dhe Dt penale apel = 260.*

Për vitin 2021 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor raportohet se të dhënat janë të padisponueshme.

Pritet të analizohen në muajin Prill 2022, në kuadrin e analizës vjetore të KLGJ.


Në këtë kontekst realizueshmëria e indikatorit për vitin 2021 nuk mund të matet.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera Bazë	2020	KLGJ: DT penale sh 1 = 66 (ditë) DT penale apel: = 246 (ditë)
------------	------	--

Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	DT penale sh 1 = 70 DT penale apel: = 260"
	2021 (targeti i arritur)	Nuk mund të matet për vitin 2021

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:




Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e zvogëlimit të kohëzgjatjes mesatare të çështjes civile në shkallën e parë dhe në apel (vlera të ndara për secilin nivel)” për vitin 2021 është: DT civile sh 1 = 198, DT civile apel: = 1600. Për këtë periudhë monitorimi, nga informacioni i raportuar për të vlerësuar realizimin e vlerës së synuar të këtij treguesi, rezulton se treguesi nuk është realizuar. Pritet të analizohen në muajin prill 2022.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera bazë	2020	Vlera: KLGJ: DT civile sh 1 = 192 (ditë) DT civile apel: = 1538 (ditë)
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	DT civile sh 1 = 198, DT civile apel: = 1600.
	2021 (targeti i arritur)	Nuk mund të matet për vitin 2021 pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor raporton se të dhënat janë të padisponueshme.

		Pritet të analizohen muajin Prill 2022, në kuadrin e analizës vjetore të KLGJ.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:




Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e çështjeve gjyqësore për të cilat informacioni bazë është në dispozicion në internet dhe i përditësuar” për vitin 2021 është 100%. Vlera e arritur për periudhën raportuese është 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera bazë	2020	100%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	100%
	2021 (targeti i arritur)	100%

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:



Niveli i realizimit të objektivit 2.4

Niveli i realizimit të *Objektivit 2.4* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 është **33% mjaftueshëm** (31 në 50 për qind e masave të realizuara).

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ OS\ 2.4 = \frac{TP\ (-\%) + TP\ (-\%) + TP\ (100X\%)}{3\ TP} \times 100\% = \text{Nuk mund të matet}^{35}$$

Vetëm nëse llogarisim vlerën e treguesit të performancës, shkalla e realizimit të objektivit 2.4 për këtë periudhë raportimi është **mjaftueshëm 33%** (31 në 50 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Qendra IT e KLGJ-së, bazuar në të dhënat e disponueshme në faqen e gjykatës.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.4

Risku i realizimit të këtij objektiv është i nivelit të lartë për shkak të faktorëve lidhur me kapacitetet administrative dhe organizimin e brendshëm duke mos përgatitur studime të fizibilitetit të infrastrukturës së gjykatave, si dhe shfaqen e riskut lidhur me bashkëpunimin ndërinsitucional

³⁵ Nuk mund të matet për vitin 2021 pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor raportoi se të dhënat janë të padisponueshme. Pritet të analizohen muajin Prill 2022, në kuadrin e analizës vjetore të KLGJ.

për të miratuar dhe zbatuar hartën e re gjyqësore. Ky risk ka një mundësi të mesme të ndodhjes dhe ndikim të lartë të tij.

- ❖ **Objektivi Specifik 2.5** “Aksesi efikas në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme”.

Për të arritur vlerat e treguesit të performancës për vitet 2021-2025 janë parashikuar masat (13) si më poshtë:

2.5.2	Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të DNJF-së dhe hartimi i planit/ kurrikulave/ programeve të trajnimit.
2.5.4	Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të ofruesve të Ndhmës Juridike parësore dhe hartimi i planit/ kurrikulës/ programit të trajnimit.
2.5.6	Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike dytësore falas dhe hartimi i planit/kurrikulës/programit të trajnimit.
2.5.8	Krijimi i forumit të bashkëpunimit të DNJF-së me grupe të tjera të interesit në sektorin gjyqësor dhe përgatitja e planit për funksionimin dhe zhvillimin e tij.
2.5.9	Hartimi, konsultimi dhe miratimi i planit të komunikimit të DNJF-së me grupet e tjera të interesit në sektorin gjyqësor.
2.5.10	Kryerja e analizës për praktikat më të mira europiane në përdorim të mekanizmave për zgjidhjen alternative dhe përgatitja e propozimeve për zbatim në Shqipëri.
2.5.11	Kryerja e ndërhyrjeve në ligjet ekzistuese për përfshirjen e mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe hartimi i planeve të implementimit të tyre.
2.5.12	Zbatimi i sistemeve të mekanizmave alternativë të mosmarrëveshjeve dhe kryerja e analizës.
2.5.13	Kryerja e analizës së vlerësimit të nevojave për trajnim të ndërmjetësve/ hartimi i planit/kurrikulës/ programit të trajnimit.
2.5.14	Trajnimi i ndërmjetësve në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ndërmjetësimit.
2.5.15	Përgatitja e një studimi në lidhje me përditësimin e tarifave gjyqësore duke përllogaritur tabelën e re të kostove me hartën e re gjyqësore dhe zbatimin e saj për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas dhe ZAM.
2.5.16	Sigurimi i mjediseve, infrastrukturës, pajisjeve, mjeteve të transportit, të mjaftueshme dhe të përshtatshme, dhe mbështetje të qëndrueshme buxhetore për funksionimin efektiv të sistemit të DNJF-së.
2.5.17	Sigurimi i burimeve të përshtatshme për operatorët dytësorë DNJF.

- ❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 2.5, ku më konkretisht përmendim:**

- Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka në funksionalitet infrastrukturën e nevojshme për të siguruar efektivitetin e plotë të sistemit. Gjithashtu, është bërë e mundur hapja e Qendrave

të reja të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Fier, Vlorë dhe Dibër (me mbështetjen e UNDP). DNJF ka ndërmarrë masat për lidhjet e marrëveshjeve “Për vendosjen në dispozicion të ambienteve pa kundërshpërblim për hapjen e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore” me institucionet ku janë vendosur këto qendra . Janë lidhur 3 marrëveshje bashkëpunimi për vendosjen në dispozicion të ambienteve për Qendrat Fier, Vlorë dhe Dibër në bazë të Urdhërit nr. 82 datë 19.02.2021, të Ministrit të Drejtësisë. Me Urdhër nr. 396 datë 08.07.2021, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin dhe kalimin nën administrimin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Falas” bëhet i mundur kalimi i Qendrës Tiranë, si qendra e dytë që mbështetet me buxhetin e shtetit.


- Qendra e Ndhmës Juridike Falas ka siguruar mbulim me avokatë, ofrues të ndihmës juridike dytësore në 100% të territorit të RSh sipas qarqeve, ku kanë nënshkruar kontratë me DNJF për ofrimin e ndihmës juridike dytësore 124 avokatë.
 - DNJF ka kryer analizën e detajuar mbi vlerësimin e nevojës për të forcuar kapacitetet e burimeve njerëzore (trajnimin e stafit), si dhe ka hartuar një plan trajnimi në bazë të rezultateve të analizës.
 - DNJF ka kryer analizën e detajuar mbi vlerësimin e nevojës për të trajnuar ofruesit e Ndhmës Juridike Dytësore pasi është dyfishuar numri i avokatëve që kanë lidhur kontratën për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike dytësore për vitin 2021, në 124 avokatë.
 - Është zhvilluar trajnimi i dedikuar për ndihmën juridike dytësore referuar ekspertizës për secilën nga kategoritë e veçanta të parashikuara nga ligji. Ky trajnim u zhvillua si rezultat si një bashkëpunimi ndërmjet UNDP, ADA, DhAsh, MD dhe FLAD. Trajnimi u konsultua në 2 sesione gjatë të cilave janë diskutuar tema specifike të ndërlidhura me ofrimin e shërbimit, parë kjo dhe nga këndvështrimi i praktikës.
 - Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve raporton se me asistencën dhe mbështetjen e ofruar nga një projekt gjerman nëpërmjet përdorimit të coaching session nga dy ekspertë të huaj, është bërë e mundur kryerja e analizës për marrjen e praktikave me të mira europiane duke përdorur mekanizmin e ndërmjetësimit për zgjidhjen e konflikteve.
- ❖ Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:
- % e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike paresore falas.
 - % e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike dytësore falas.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike paresore falas” për vitin 2021 është rritje 5 % në krahasim me vlerën bazë. Vlera bazë do të jetë viti 2020, pra 4200 persona kanë përfituar ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti. Gjatë vitit 2021, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas raporton se 32 ofrues të shërbimit të ndihmës juridike të cilët gjejnë shtrirje në mbi 95 % të territorit të vendit (10 dhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike. **Për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë raportuar 8153 raste të përfitimit të ndihmës juridike parësore.** Pra, synimi për vitin 2021 është tejkaluar **duke u rritur me 94.12%.**

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera Bazë	2020	4200 persona kanë përfituar ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti.
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	Rritje 5 % në krahasim me vlerën bazë
	2021 (targeti i arritur)	8153 raste të përfitimit të ndihmës juridike parësore duke u rritur me 94.12%. Realizuar në masën 194%.

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:



Ky tregues ka tejkaluar realizueshmërinë për vitin 2021.


Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e aplikimeve të pranuar për të marrë ndihmë juridike dytësore falas“ për vitin 2021 është: Rritje 15% në krahasim me vlerën bazë. Vlerë bazë 157 (numri i personave që kanë përfituar ndihmë juridike dytësore)

Gjatë vitit 2021 rezulton se 92% e qytetarëve u është pranuar ndihma juridike dytësore. Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore 356. Për vitin 2021 numri i personave që kanë përfituar ndihmë juridike dytësore referur vlerës bazë është rritur me 127%. Viti 2021/ gjithsej 849 vendime gjyqësore.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera bazë	2020	157 (numri i personave që kanë përfituar ndihmë juridike dytësore)
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	Rritje 15% në krahasim me vlerën bazë
	2021 (targeti i arritur)	Treguesi është arritur në masën 127%

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:



Niveli i realizimit të Objektivit 2.5

Niveli i realizimit të Objektivit 2.5 në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar-dhjetor 2021 **është 160%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 2.5 = \frac{TP\ (194\%) + TP\ (127\%)}{2\ TP} \times 100\% = 160\%$$

Nisur nga realizimi i masave të raportuara, shkalla e realizimit të objektivit 2.5 për këtë periudhë raportimi **është tejkaluar (111 dhe më lart)**

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, statistikat etj.

Risqet për realizimin e Objektivit 2.5

Risku i realizimit të këtij objektivi ndikim të “mesëm” në arritjen e objektivit, pasi evidentohen rreziqeve të lidhura me burimet njerëzore të pamjaftueshme duke sjellë ngarkesë për institucionin e DNJF-së, që mund të rezultojë në mosrealizimin në kohë të masave të parashikuara. Ky risk mund të përmirësohet duke dërguar në Ministrinë e Drejtësisë propozimin për ndryshimin e strukturës aktuale të DNJF me qëllim shtimin e numrit të punonjësve të Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore si dhe plotësimin e nevojave me punonjës IT dhe specialist/jurist prokurimesh.

Realizueshmëria e objektivave specifike të dytë të politikës

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 11 objektivave specifike të qëllimit të dytë të politikës.

Realizueshmëria e qëllimit strategjik për qëllimin e dytë të politikës **është 94%**.

Objektivi	Realizueshmëria
2.1 Rishikimi i kuadrit ligjor në lidhje me gjyqësorin sipas nevojës për të përmirësuar më tej aftësinë profesionale, aksesueshmërinë, transparencën dhe eficientë.	100%
2.2 Fuqizimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve të Gjykatës Kushtetuese (GJK), sigurimi i burimeve të përshtatshme dhe funksionimi i saj profesional, në mënyrë transparente dhe efektive.	100%
2.3 Rritja e efikasitetit dhe aftësisë profesionale të sistemit të trajnimit i cili siguron avancimin drejt praktikave evropiane dhe cilësisë në fushën e drejtësisë duke siguruar një numër të përshtatshëm të magistratëve dhe këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë të trajnuar për sistemin e drejtësisë në Shqipëri.	74%
2.4 Përmirësimi i sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.	Nuk mund të matet
2.5 Aksesit efikas në drejtësi i siguruar nëpërmjet ndihmës juridike, zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe tarifave gjyqësore të përshtatshme.	160%

✚ QËLLIMI I TRETË I POLITIKËS “Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit”.


Qëllimi i tretë i politikës synon ngritjen e një sistemi drejtësie penale të mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, i cili garanton risocializimin, riintegrimin, rehabilitimin, respektimin e të drejtave e lirive të njeriut dhe barazinë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit.

Ai lidhet me objektivin 16 të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse, garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, qëllimi i tretë i politikës lidhet me nënobjektivat 16.3, “Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë”, 16.6, “Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet”, dhe 16.7, “Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet”.

Qëllimi i Tretë i Politikës	Objektivat dhe Masat	Realizimi i Masave			
		OS dhe masa të parashikuara për vitin 2021	OS dhe masa plotësisht të realizuara	OS dhe masa pjesërisht të realizuara ³⁶	OS dhe masa të parealizuar ³⁷
Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit	Objektiva Specifik	4	0	3	1
	Masa	46	13	24	9

³⁶ Masë "pjesërisht e realizuar" është ajo masë që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

³⁷ Masë "e parealizuar" është ajo e cila është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind



Rezultoni se nga 4 objektiva specifike e 46 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2021 – 2025, për janar-dhjetor 2021, për Qëllimin e Politikës 3 janë zbatuar 0 os dhe 13 masa, rezultojnë 3 o.s dhe 24 masa të realizuara pjesërisht dhe rezultojnë të parealizuar 1 o.s dhe 9 masa.


Nga 6 treguesit e performancës të analizuar për vitin 2021 për qëllimin e politikës 3:

- është arritur vlera e synuar plotësisht për 5 tregues performance;
- është arritur pjesërisht vlera e synuar për 1 tregues performance.

Qëllimi i Tretë i Politikës	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ³⁸	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ³⁹	Vlera e synuar nuk është e realizuar ⁴⁰
	6	5	1	0

³⁸ Që është realizuar në shkallën 100 për qind

³⁹ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.



Indikator në nivel Qëllimi: % e ankesave të personave që vuajnë dënimin në IEVP lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut, *pra në nivel qëllimi*. Vlera bazë do të jetë 62%. Vlera e synuar për treguesin e performancës për vitin 2021 është 55%. Treguesi ka si qëllim të masë impaktin e institucioneve të ekzekutimit të të dënimeve penale në drejtim të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të personave të dënuar që janë duke vuajtur dënimin pranë këtyre institucioneve (IEVP). Treguesi krijohet për herë të parë.

Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e realizimit të vlerës së synuar të këtij treguesi, rezulton se treguesi është arritur në masën 4.76%. Indikatori ka trend zbritës. Indikatori është realizuar 100%. Në sistemin penitenciar përmes punës së implementuar nga sektorët përkatës është përmirësuar dukshëm puna në drejtim të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të personave të dënuar që janë duke vuajtur dënimin pranë IEVP . Do të vijohet me punën ndërsektoriale në kuadër të përbushjes së të drejtave dhe trajtimit human të personave të dënuar që janë duke vuajtur dënimin pranë IEVP-ve, bazuar në tërë infrastrukturën ligjore dhe nënligjore në fuqi që normon të tillë vizion e mision.

Vlera bazë	2020	62%
	2021 (targeti i synuar)	55%

Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i arritur)	4.76%

Objektivi Specifik 3.1 “Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese”.

❖ Plani i veprimit për Objektivin 3.1 parashikon 14 masa⁴¹.

3.1.1	Kryerja e studimit të analizës për ndërhyrjet e mundshme në Kodin Penal.
3.1.2	Përgatitja e një studimi të detajuar për praktikën më të mira evropiane, në funksion të ndryshimeve të KP-së, konsultimi me institucionet përkatëse për praktikën më të mirë për parandalimin e krimit dhe shpërndarja e analizës.
3.1.3	Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në Kodin Penal bazuar në gjetjet e analizës.
3.1.4	Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit / finalizimi i paketës dhe miratimi.
3.1.7	Kryerja e studimit të status quo-së dhe analizës së ndërhyrjes për Kodin e Procedurës Penale (KPP).
3.1.8	Përgatitja e një studimi të detajuar për praktikën më të mira evropiane, në funksion të ndryshimeve të KPrP, konsultimi me institucionet përkatëse për praktikën më të mirë për parandalimin e krimit dhe shpërndarja e analizës.
3.1.9	Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale bazuar në gjetjet e analizës.
3.1.10	Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi.
3.1.11	Kryerja e analizës dhe përgatitja e raporteve të monitorimit në lidhje me zbatueshmërinë e Kodit të Procedurave Penale, të ndryshuar.
3.1.13	Ngritja dhe funksionimi i Grupit Tematik për Drejtësinë Penale.

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 2.3, ku më konkretisht përmendim:**

- Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, filloi puna për rishikimin e Kodit Penal aktual me qëllim hartimin e një Kodi të ri Penal. Për realizimin e këtij procesi u ngrit grupi i punës me ekspertë të jashtëm me qëllim hartimin e një Kodi të ri Penal të karakterizuar nga qëndrueshmëria, largpamësia, si dhe përshtatja me dinamizmin e marrëdhënieve shoqërore ekzistuese, në përputhje me aktet ndërkombëtare, me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane

⁴¹ Masat 3.1.5, 3.1.6, 3.1.6, 3.1.12 do të fillojnë zbatueshmërinë pas vitit 2021.

për të Drejtat e Njeriut, me jurisprudencën e gjykatave të brendshme (Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese), me doktrinën e elaboruar ndër vite, si dhe me modelet më të mira të ligjeve penale evropiane. Me qëllim realizimin e këtij objekti, grupi i ekspertëve kryejti një studim të detajuar mbi nevojën për hartimin e Kodit Penal, problematikat e hasura në teori e praktikë si dhe nevojën për përafrimin me standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare.

- Përpos hartimit të analizës për ndërhyrjen në legjislacionin penal, grupi i ekspertëve ka hartuar edhe metodologjinë mbi hartimin e Kodit të ri Penal. Gjithashtu, miratimi i Kodit Penal është vendosur edhe si një ndër objektivat e kapitullit 23 të acquis së Bashkimit Evropian në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian për vitin 2021-2023 dhe 2022 – 2024, me qëllim përafrimin e tij me një sërë direktivash të Bashkimit Evropian.
- Kryerja e studimit të status quo-së dhe analizës së ndërhyrjes për Kodin e Procedurës Penale (KPP) është realizuar në vitin 2020-2021 me një përfshirje ndërinstitucionale, konkretisht me përfaqësues të sistemit të drejtësisë (KLP, KLGJ, ILD, GJL, PP), nën kryesimin e Ministrisë së Drejtësisë, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e misionit të asistencës teknike Euralius. Nisma në fjalë, që prej fillimit të saj, është hartuar nga ekspertë të nivelit të lartë të drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe partnerët e kësaj reforme EURALIUS dhe OPDAT. Këto ndryshime ligjore janë depozituar nga deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

❖ **Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:**


Shkalla e ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale që reflektojnë standardet ndërkombëtare të drejtësisë penale.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “Shkalla e ndryshimeve në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale që reflektojnë standardet ndërkombëtare të drejtësisë penale“ për vitin 2021 është: Kodi Penal 100 %, Kodi i Procedurës Penale 0 %. Treguesi ka si qëllim të masë shkallën e ndryshimeve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale që reflektojnë standardet ndërkombëtare. Treguesi matet përmes analizës së MD në lidhje me vlerësimin e ndryshimeve të KP dhe KPrP. Vlera e arritur për vitin 2021 KP 10%, KPrP 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera Bazë	2020	KP 3%; KPrP 1%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	KP 100 % KPrP 0 %
	2021 (targeti i arritur)	KP 10 % KPrP 100 %

Realizueshmëria e indikatorit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:



Niveli i realizimit të objektivit 3.1

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.1*, në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **100%**.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.1 për këtë periudhë raportimi është *shumë mirë 80-110%*.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.1

Risku i realizimit të këtij objektiv është i nivelit të ulët, ka mundësi të ulët të ndodhjes dhe ndikim të ulët të tij, pasi nuk paraqet risk evident.

Objektivi Specifik 3.2 “Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekja efikase të korrupsionit dhe e krimin të organizuar”.

❖ Plani i veprimit për Objektivin 3.1 parashikon 15 masa⁴².

3.2.1	Përmirësimi i menaxhimit strukturor dhe administrimit të prokurorisë nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit eficient të burimeve njerëzore dhe buxhetit.
3.2.2	Kryerja e studimit të status quo-së dhe analizës së ndërhyrjes në ligjin organik të prokurorisë.
3.2.3	Përgatitja e paketës së propozimeve për ndryshimet në ligjin organik të prokurorisë bazuar në gjetjet e analizës.
3.2.4	Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi i ligjit organik të prokurorisë, të ndryshuar.
3.2.8	Kryerja e analizës së nevojave për trajnim për rritjen e kapaciteteve të magjistratëve prokurorë/OPGJ për kuadrin ligjor dhe nënligjor/ hartimi i moduleve të trajnimit.
3.2.10	Përgatitja e analizave të rregullta ndërinstucionale mbi eficientësinë e hetimeve ndaj pastrimit të parave, hartimi i raporteve të analizës mbi evidentimin e problematikave dhe përgatitja e paketës së rekomandimeve.
3.2.11	Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të SPAK-ut.
3.2.12	Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të BKH-së.
3.2.13	Kryerja e analizës së nevojave për trajnim për rritjen e kapaciteteve të prokurorëve të SPAK-ut, hetuesve BKH-së, përgatitja e kurrikulave dhe moduleve të trajnimit
3.2.14	Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale të SPAK-ut (trajnime/seminare).
3.2.15	Zhvillimi dhe rritja e kapaciteteve institucionale të BKH-së (trajnime/seminare).

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 3.2, ku më konkretisht përmendim:**

- Për të shmangur efektet e uljes së numrit të prokurorëve nga procesi i vetëgjetjes, Kuvendi i RSH, me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm ka shtuar 30 vende për oficerë të policisë gjyqësore në strukturën e prokurorisë, shoqëruar me fondin përkatës nga Ministria e Financës. Gjithashtu në vijimesi, duke analizuar kërkesat dhe nevojat e prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm janë kryer ndërhyrje strukturore për funksionimin sa më eficient të prokurorisë.
- Në zbatim të detyrimit ligjor për ndjekjen e trajnimeve vazhduese sipas ligjit 96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në RSH” është kryer analiza për rritjen e kapaciteteve të Prokurorisë të cilët trajnohen periodikisht në Shkollën e Magjistraturës sipas temave të përzgjedhura prej tyre. Përsa u përket oficerëve të policisë gjyqësore menjëherë pas emërimit kryhet trajnimi i tyre në Akademinë e Sigurisë, ku për vitin 2021 janë trajnuar dy grupe. Raundi i parë i procesit transparent dhe meritokratik të rekrutimit për hetuesit e BKH-së rezultoi me emërimin e 28 hetuesve, të cilët, pas një programi intensiv trajnimi tre-mujor, tashmë janë operacionale.

⁴² Masat 3.1.5, 3.1.6, 3.1.6, 3.1.12 do të fillojnë zbatueshmërinë pas vitit 2021.

❖ **Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:**


- *Përqindja e çështjeve që shkojnë në gjyq në të cilat i pandehuri është lënë i lirë.*

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “*Përqindja e çështjeve që shkojnë në gjyq në të cilat i pandehuri është lënë i lirë*” për vitin 2021 është: 97.50%. Nga të pandehurit gjykuar në shkallë të parë, veçohen ata për të cilët është dhënë një vendim pafajësie ose pushimi. Vlera e arritur për vitin rezulton 69 %. Nga të dhënat e Zyrës së Statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se gjatë vitit 2021, për veprat penale të korrupsionit në kompetencë lëndore të prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm janë ndjekur në gjendje të lirë 69% e personave nën hetim/të pandehur. Në këtë shifër bëjnë pjesë edhe veprat penale të korrupsionit që me datë 1 qershor 2021 kanë kaluar në kompetencë lëndore të Prokurorisë së Posaçme.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera Bazë	2020	
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	97.50%
	2021 (targeti i arritur)	69%
	2022	97.50%
Vlera e synuar/Targeti	2023	97.55%

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:



Niveli i realizimit të objektivit 3.2

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.2* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 **69%**.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.2 për këtë periudhë raportimi është *mirë*.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga SPAK për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.2

Nuk evidentohet risk.

Objektivi Specifik 3.4 “Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikatat dhe standardet më të mira të BE-së”.

❖ Plani i veprimit për Objektivin 3.4 parashikon 11 masa.

3.4.1	Kryerja e analizës në lidhje me nivelin e zbatueshmërisë dhe nevojën për ndryshime të kuadrit ligjor në lidhje me DPSHP-në dhe strukturën organizative të saj për t'u përshatur me standardet evropiane.
--------------	--

3.4.3	Kryerja e analizës së nevojave për trajnim të burimeve njerëzore pranë DPSHP-së dhe përgatitja e planit të trajnimit / kurrikulave dhe programeve të trajnimit (trajnimi bazë dhe vazhdues).
3.4.4	Trajnimi i nëpunësve të DPSHP-së për rritjen e performancës në kryerjen e funksioneve (trajnim bazë dhe vazhdues).
3.4.5	Konsolidimi dhe finalizimi i marrëveshjeve të binjakëzimit/bashkëpunimit me partnerët institucionalë evropianë.
3.4.6	Kryerja e analizës së funksionimit të sistemit të administrimit të çështjeve dhe përgatitja e rekomandimeve për përmirësimin.
3.4.7	Dizenjimi dhe instalimi i teknologjisë së informacionit bashkëkohor si dhe sistemit të administrimit të çështjeve, duke krijuar lidhje me sistemin e integruar të drejtësisë elektronike.
3.4.10	Hartimi i paketës së akteve nënligjore specifike, rregulloreve, udhëzimeve, standardeve/ konsultimi i paketës dhe miratimi.
3.4.15	Kryerja e analizës në lidhje me nevojën për bashkëpunim të DPSHP-së me institucionet përkatëse të drejtësisë dhe hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për punën në shërbimin e provës në fazën para dënimit.
3.4.17	Përgatitja e një programi të përbashkët komunikimi me popullatën e gjerë.
3.4.18	Përgatitja e programeve të bashkëpunimit me KLGJ-në, KLP-në, PP-në, SHM-në për të informuar për qasjet e reja dhe mundësitë e një shërbimi modern prove sipas standardeve europiane.
3.4.19	Rritja e kapaciteteve të stafit për të siguruar një normë prej 50 stazhierësh për staf në përputhje me standartet evropiane dhe për të siguruar stafin e duhur për zyrat vendore, si dhe struktura e pagave u rishikua për të siguruar pagesën e duhur në të gjithë organizatën sipas aftësive dhe përgjegjësisë në përputhje me skemën zyrtare të pagave.

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 3.4, ku më konkretisht përmendim:**

- Kuvendi i Shqipërisë, me angazhimin e veçantë të ministrisë së Drejtësisë ka miratuar paketën e re penitenciare të ligjeve, e cila është një paketë e plotë ligjore, që synon të rregullojë menaxhimin në sistemin penitenciar në Shqipëri, nën frymën e konventave europiane dhe ndërkombëtare më të mira që rregullojnë këtë fushë. Një ndër këto ligje është dhe Ligji nr. 78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës”, i cili parashikon 8 akte nënligjore për rregullimin dhe mirëfunksionimin e Shërbimit të Provës. Nga këto akte nënligjore janë miratuar 6 prej tyre, dhe janë në proces 2 akte.
- Është hartuar rregullorja e përgjithshme e Shërbimit të Provës, e cila më pas është miratuar dhe ka hyrë në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 421, datë 08.07.2021 “Për miratimin e rregullores së përgjithshme të Shërbimit të Provës”.

- Sektori i monitorimit të institucioneve të varësisë në fushën penale: Në zbatim të ligjit nr. 78/2020 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës" janë miratuar aktet nënligjore: **(i)** Rregullorja e Përgjithshme e Shërbimit të Provës (VKM nr.421, date 08.07.2021) **(ii)** Urdhër nr. 452, date 31.12.2020 Rregullorja e brendshme e Shërbimit të Provës (rregullorja e disiplinës) **(iii)** Urdhër nr. 453, date 31.12.2020 Per miratimin e modelit të raportit të vleresimit për të miturin në konflikt me ligjin, personin nën hetim, të pandehurin, personin nën mbikqyrje dhe raportin periodik të vleresimit **(iv)** Urdhër nr. 454, date 31.12.2020 Per miratimin e formatit të raportit të vleresimit për mospermbushje të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale e të miturit në konflikt me ligjin **(v)** Urdhër nr. 455, date 31.12.2020 i ministrit të Drejtësisë mbi Rregullat e detajuara për të dhenat që përmban plani individual i trajtimit dhe mënyrën e hartimit të tij. **(vi)** Urdhër nr.456, date 31.12.2020 i ministrit të Drejtësisë mbi Formatin, përmbajtjen dhe mënyrat e krijimit dhe të administrimit të regjistrave.
- Ndërkohë, janë në proces miratimi 2 akte nënligjore si më poshtë vijon: **(i)** Urdhër i ministrit të drejtësisë mbi Formatin e raportit të vleresimit për kohën, vendin, mënyrën dhe rrethanat e mospermbushjes, si dhe situatën personale të të miturit. **(ii)** Urdhër i Ministrit të Drejtësisë mbi Procedurat e bashkepunimit për zbatimin e alternativave të denimit me burgim në zbatim të rregullave të Konventës Evropiane.

❖ **Për këtë objektiv janë përcaktuar 2 tregues performance:**


- *% e numrit të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet të cilat përfshijnë dënime alternative*
- *Raporti i personave nën mbikqyrjen e Shërbimit të Provës të liruar me kusht (ose disa forma të tjera të lirisë me kusht), të cilët e kanë kryer periudhën e provës me sukses.*

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e numrit të vendimeve penale për vepra të dënueshme deri në 5 vjet të cilat përfshijnë dënime alternative“ për vitin 2021 është: 65%. Vlera e arritur për vitin 2021 është 69 %. Pra vlera ka tejkaluar vlerën e synuar për vitin 2021.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit:

Vlera bazë	2020	49%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	65%
	2021 (targeti i arritur)	69% Realizuar 100%

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:




Vlera e synuar për **treguesin e performancës** - “Raporti i personave nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës të liruar me kusht (ose disa forma të tjera të lirisë me kusht), të cilët e kanë kryer periudhën e provës me sukses” për vitin 2021 është: 99%. Vlera bazë: Viti 2020/ 99.9% (vetëm një person ka kryer vepër tjetër penale gjatë periudhës së lirimit me kusht) Ky indiaktor është i rëndësishëm për matjen e cilësisë së punës së Shërbimit të Provës lidhur me të denuarit me shërbim prove. Nga të dhënat e raportuara nga Shërbimi i Provës, vlera e arritur për vitin 2021 është 111%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit paraqitet si vijon:

	2020	99.9% (vetëm një person ka kryer vepër tjetër penale gjatë periudhës së lirimit me kusht)
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	99.9%
	2021 (targeti i arritur)	111%

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë:



Niveli i realizimit të objektivit 3.4

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.4* “Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikat dhe standardet më të mira të BE-së” në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 **është 105%**.

Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 3.4 = \frac{TP\ (100\%) + TP\ (111\%)}{2\ TP} \times 100\% = 105\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit 3.4 për këtë periudhë raportimi është **105 shumë mirë (85 në 110 për qind e masave të realizuara)**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Shërbimi i Provës për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.4

Risku i realizimit të këtij objekti është i nivelit të lartë, ka mundësi të lartë të ndodhjes dhe ndikim të lartë të tij, pasi raportohen rreziqe lidhur me organizimin e brendshëm (menaxhimi, rolet dhe përgjegjësitë) si dhe ka mungesë trajnimesh të vazhdueshme për të forcuar kapacitetet njerëzore.

Objektivi Specifik 3.5 “Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individuale”.

❖ Plani i veprimit për vitin 2021 për Objektivin 3.5 parashikon 14 masa.

3.5.1	Kryerja e analizës në lidhje me nevojën për hartimin e legjislacionit/ akteve nënligjore/ rregulloreve sipas ndryshimeve të paketës legjislativë penitenciare.
3.5.2	Hartimi/konsultimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe rregulloreve specifike (Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve/ Kodi i Etikës/Shërbimi i sigurimit/policia e burgjeve/punësimi i të burgosurve) (3 konsultime)
3.5.4	Hartimi dhe miratimi i skemës dhe standardeve për (i) mbikëqyrjen e rregullt psikologjike për të gjithë stafin (ii) vlerësimin e performancës për IEVP dhe pilotimi i skemave në 4 IEVP.
3.5.7	Përgatitja e moduleve të programeve për parandalimin e recedivizmit (i) për kriminelët seksualë dhe kriminelët e dhunshëm (ii) për personat e varur nga droga, alkooli dhe pilotimi në 8 IEVP.
3.5.8	Trajnimi i stafit në lidhje me programet për parandalimin e recedivizmit.
3.5.9	Dizanjimi dhe konsolidimi i koncept dokumentit për Strategjinë për përmirësimin e funksionimit të sistemit të burgjeve (plani I masave për arsimimi I të burgosurve/shërbime sociale/planifikimi para-lirimi/mbështetje pas lirimt).
3.5.10	Konsultimi/ finalizimi dhe miratimi i planit të veprimit strategjik dhe prezantimi në një tavoline të rrumbullakët.
3.5.11	Hartimi, Konsolidimi dhe finalizimi i memorandumit të bashkëpunimit me MSHMS për kujdesin dhe trajtimin e shkelësve të papërgjegjshëm dhe në kujdesin e pacientëve të dënuar me probleme mendore dhe të atyre në paraburgim dhe memorandum me institucionet e tjera.
3.5.12	Hartimi, konsultimi dhe miratimi i protokollit për funksionimin e Njësive të kujdesit të Posaçëm në burgje, për të ofruar një mjedis më të përshtatshëm dhe përgatitja e udhëzimeve të nevojshme për zbatimin e tij.
3.5.13	Kryerja e analizës së vlerësimit të kuadrit legjislativ, menaxhimit të çështjeve dhe kapaciteteve institucionale për të identifikuar fushat e riskut dhe për të kuptuar dobësitë e sistemit.

3.5.14	Identifikimi i mjetit të vlerësimit të riskut për tu miratuar në sistemin e burgjeve në Shqipëri dhe pilotimi në 4 IEVP.
3.5.15	Konsolidimi dhe finalizimi i dokumentit operacional të brendshëm për procedurat që do të ndiqen në lidhje me regjimet e brendshme, trajtimi individual, programet e disponueshme ose programet që duhet të zhvillohen në kohën kur këta të burgosur do të dërgohen në institucionin e vuajtjes së dënimit.
3.5.16	Trajnime të nëpunësve të sistemit të burgjeve për të rritur performancën e tyre në sistem lidhur me (i) Funksonimi e njërive të kujdesit të posacëm në rrugë (ii) analizën / vlerësimin e rrishtut (iii) kuadrit ligjor/nënligjor në fuqi.
3.5.17	Konsolidimi dhe përmirësimi i mekanizmave ndërinstiucional për adresimin e Shkelësve Ekstremist të Dhunshëm (1-7 mbledhje koordinimi).

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 3.5 ku më konkretisht përmendim:**

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë pas kryerjes së analizës në lidhje me nevojën për hartimin e legjislacionit, ka ndërmmarrë të gjitha proceset për të hartuar draft-aktet nënligjore sipas ndryshimeve të paketës legjislative penitenciare. Gjithashtu janë hartuar të gjitha rregulloret, ku ndër to është në proces miratimi Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve me Vendim të Këshillit të Ministrave. Është përfunduar hartimi /konsultimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme ligjore dhe rregulloreve specifike (Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve/ Kodi i Etikës/Shërbimi i sigurimit/policia e burgjeve/punësimi i të burgosurve.
- Është arritur të lidhet Marrëveshja e përbashket e bashkëpunimit midis Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit përgjegjës për shëndetësinë për "Trajtimin e te burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor". Gjithashtu, midis MD dhe MSHMS është ngritur grupi i punës "Për ngritjen e grupit ndërinstiucional të punës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit "Për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, me masë mjekësore" dhe planit të përbashkët të veprimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore.
- Janë krijuar SKV në IEVP Durrës, Fier, Malësië Madhe Reç, Peqin, Rrogozhinë, Ali Demi, Jordan Misja, Lezhë, Elbasan.
- Ka vijuar evidentimi i rasteve të reja për të burgosur me probleme të shëndetit mendor dhe për shkak të mungesës së infrastrukturës janë krijuar dhoma të veçanta për akomodimin e të burgosurve. DPB ka zhvilluar analiza të hollësishme dhe verifikime në vend në çdo IEVP për këtë target grup.
- DPB ka ndërmarrë iniciativën e ristrukturimit dhe rialokimit të aseteve njerëzore profesionale, dhe gjatë këtij procesi është menduar ngritja e strukturës që do të mbulojë procesin e vlerësimit analizimit dhe prodhimit të gjetjeve analitike sa lidhet me efektshmërinë e institucionit.

❖ **Për këtë objektiv janë përcaktuar 1 tregues performance:**

- Raporti i personave për nr. shtreterish, p.sh. si një masë për mbipopullimin e burgjeve.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “Raporti i personave për nr. shtreterish, p.sh. si një masë për mbipopullimin e burgjeve” është 83%. Vlera bazë është 88%. Nga të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezulton se vlera e arritur për vitin 2021 **-14%** (mesatarja e mbipopullimit / 12 muaj x 100 = - 14 %). Ky indikator lidhet ngushtazi me hyrjet në institucion dhe infrastrukturën aktuale që sistemi ka.

Stafi përmes punës organizative / proceseve të transferimit, etj. do të vijojë të menaxhojë çështjen e mbipopullimit. Kryerjes rast pas rasti të një studimi të kujdesshëm të shpërndarjes dhe akomodimit të burgosurve në IEVP, duke pasur në konsideratë:

Eliminimi i mbipopullimit në burgje, përveç arsyeve të raportuara më pare, ka ardhur si rezultat dhe i: Kryerjes rast pas rasti të një studimi të kujdesshëm të shpërndarjes dhe akomodimit të burgosurve në IEVP, duke marrë në konsideratë: Garantimin e të drejtës sipas kriterit të vendqëndrimit të tyre në një IEVP sa më afër vendbanimit; Nevojat e realizimit të procedurës së hetimit penal dhe gjyqimit me kosto sa më të ulët (kohë e shpenzime) si dhe për një risk sigurie sa më të ulët; Kapacitetin e normën e popullimit në paraburgimet më të afërta.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit paraqitet si vijon:

	2020	88%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	55%
	2021 (targeti i arritur)	-14% Realizuar 100%

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:



Niveli i realizimit të objektivit 3.5

Niveli i realizimit të *Objektivit 3.5* “Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individuale” në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është **100%**.

Shkalla e realizimit të objektivit 3.5 për këtë periudhë raportimi është **100%** (Nga 86 në 110 për qind e masave të realizuara).

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Risqet për realizimin e Objektivit 3.5

Risku i realizimit të këtij objektiv ka mundësi të “mesëm” të ndodhjes dhe ndikim të “ulët”, pasi evidentohen rreziqeve të lidhura me planifikimin e sistemeve mbështetëse për funksionimin e IEVP-ve dhe trajtimin e të dënuarve.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit të tretë të strategjisë

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 4 objektivave specifike të qëllimit të tretë të politikës.

Realizueshmëria e Qëllimit të tretë të Politikës është **95%**.

Objektivi	Realizueshmëria
3.1 Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale janë përditësuar duke synuar një qasje të integruar të institucioneve të drejtësisë dhe një qasje restauruese të drejtësisë, ndërtuar mbi parandalimin, risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin duke zëvendësuar qasjen ndëshkuese ekzistuese.	100%
3.2 Një sistem prokurorie efikas dhe proaktiv që funksionon sipas standardeve evropiane me qëllim hetimin dhe ndjekja efikase të korrupsionit dhe e krimit të organizuar.	69%
3.4 Një shërbim prove efektiv dhe efikas që përdor standardet operacionale, metodologjitë e mbikëqyrjes dhe menaxhimin e individualizuar të çështjeve, mbështet risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin dhe punon në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira të BE-së.	105%
3.5 Zhvillimi i sistemit penitenciar bazuar në standardet evropiane, që siguron respekt të plotë për burimet njerëzore dhe përdor plane zhvillimi individuale.	100%

✚ QËLLIMI I KATËRT I POLITIKËS “Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit”

Qëllimi i katërt i politikës synon koordinimin dhe menaxhimin efikas dhe efektiv të sektorit në të gjitha institucionet e drejtësisë. Ai është i lidhur me objektivin 16 të *objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm*, i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse, garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Në veçanti, ky objektivi lidhet me nënobjektivat 16.3, “*Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për të gjithë*”, 16.6, “*Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet*”, dhe 16.7, “*Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet*”.

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat sipas tabelës më poshtë.


Qëllimi i Katërt i Politikës	O.S dhe Masat	Realizimi i Masave			
		O.S dhe masa të parashikuara	O.S dhe masa plotësisht	O.S dhe masa pjesërisht	O.S dhe masa të përealizuara ⁴⁴

⁴⁴ Masë “e përealizuar” është ajo e cila është realizuar në një shkallë nga 0 në 50 për qind

		për vitin 2021	të realizuara	të realizuara ⁴³	
Koordinimi, manaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.	O.S	4	0	2	2
	Masa	36	7	7	22

Rezulton se nga 4 Objektiva Strategjik dhe 36 masa të parashikuara në Planin e Veprimit 2020-2025, për janar-dhjetor 2021 rezulton se për Qëllimin e Politikës 4:

- 7 masa janë realizuar plotësisht,
- 2 Objektiva Strategjik/7 masa rezultojnë pjesërisht të realizuara
- 2 Objektiva Strategjik/22 masa rezultojnë të pazbatuara. Konkretish:(O.S 4.1, O.S 4.2, masa 4.1.1, 4.1.2, 4.1.6, 4.1.7, 4.1.8, 4.1.10, 4.1.11, 4.1.12, 4.1.13, 4.1.14, 4.1.15).




⁴³ Masë "pjesërisht e realizuar" është ajo masë që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

Nga 5 treguesit e performances të marrë në analizë për vitin 2021 për qëllimin e politikës 4 rezultojn se:

- është **arritur** vlera e synuar për 3 tregues performance
- është arritur **pjesërisht** vlera e synuar për 2 tregues performance

Qëllimi i Katërt i Politikës	Treguesit e performancës	Realizimi i Treguesve të Performancës		
		Vlera e synuar është realizuar plotësisht ⁴⁵	Vlera e synuar është realizuar pjesërisht ⁴⁶	Vlera e synuar nuk është e realizuar ⁴⁷
	5 ⁴⁸	3	2	0



Indikator në nivel Qëllimi: “Numri i akteve ligjore të BE-së të harmonizuara siç duhet me *acquis* (kapitulli 23)“, pra në nivel qëllimi. Vlera e synuar për treguesin e performancës për vitin 2021 është 2 akte ligjore të BE-së të harmonizuara. Nga informacioni i raportuar dhe analizuar për të kryer vlerësimin e realizimit të vlerës së synuar të këtij treguesi, rezultojn se treguesi është arritur në masën 0%, **pasi gjatë vitit 2021 nuk është harmonizuar asnjë akt ligjor i BE-së.**

⁴⁵ Që është realizuar në shkallën 100 për qind


⁴⁶ Që është realizuar në shkallën nga 50 deri në 100 për qind.

⁴⁷ Që nuk është realizuar dhe tregues për të cilin nuk janë mbledhur ose nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna

⁴⁸ Indikator i Objektivit Specifik 4.1 nuk mund të matet për vitin 2021.

Vlera bazë	2020	0
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	2
	2021 (targeti i arritur)	0

Realizueshmëria e indiaktorit në mënyrë grafike si më poshtë vijon:



Objektivi Specifik 4.1 “Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare”.

❖ Plani i veprimit për vitin 2021 referuar Objektivi 4.1 parashikon 12 masa.

4.1.1	Dizenjimi i programit të digjitalizimit të institucioneve të drejtësisë.
4.1.2	Ngritja dhe zbatimi i programit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata/KLGJ/KLP/ILD.
4.1.6	Projektimi, zhvillimi dhe instalimi i bazës së të dhënave.
4.1.7	Ngritja e sistemit të menaxhimit të çështjeve të prokurorisë me standardet aktuale teknologjike e legjislative dhe mirëmbajtja e softëare-t të sistemit.
4.1.8	Mirëmbajtja për sistemin e menaxhimit të çështjeve për gjykatat/PP/KLP/KLGJ/ILD.
4.1.9	Përgatitja e paketës ligjore të nevojshme për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit.
4.1.10	Ngritja e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit të Sistemit të Drejtësisë dhe sigurimi i mbështetjes së nevojshme për funksionalizimin e veprimtarisë së saj.
4.1.11	Trajnimi i trupës gjyqësore/prokurorë/inspektorë dhe i stafit administrativ mbi përdorimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve.
4.1.12	Hartimi dhe miratimi i planit strategjik për teknologjinë e informacionit në gjykata dhe institucionet e drejtësisë.
4.1.13	Investime dhe mirëmbajtje për sistemin e menaxhimit të çështjeve dhe pajisjet dhe softëare-t respektive për gjykatat /KLP-në/KLGJ-në/ILD-në.
4.1.14	Investime dhe mirëmbajtje për sistemin e menaxhimit të çështjeve dhe pajisjet dhe softëare-t respektive për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e saj të varësisë.
4.1.15	Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë.

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 4.1 ku më konkretisht përmendim:**

- Për të filluar procesi i organizimit dhe funksionimit të brendshëm të Qendrës, janë miratuar një sërë vendimesh si më poshtë:
 - Vendimi nr. 1 dt. 19.10 2021 "Për deklarimin e ngritjes së Bordit Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë"

- Vendimi nr. 2 dt. 19.10.2021 “Për deklarin e Krijimit te Qendrës se Teknologjisë se Informacionit për Sistemin e Drejtësisë"
- Vendimi nr. 3 dt. 19.10.2021 "Për Shpalljen e Vendit Vakant ne Pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv, ne Qendrën e Teknologjisë se Informacionit për Sistemin e Drejtësisë"
- Vendimi nr. 4 dt. 17.12.2021 "Për Miratimin e Procesverbalit te mbledhjes se Bordit Drejtues te Qendrës se Teknologjisë se Informacionit për Sistemin e Drejtësisë"
- Vendimi nr. 5 dt. 17.12.2021 " Për emërimin e z. Ervin Miso ne pozicionin e drejtorit ekzekutiv, ne Qendrën e Teknologjisë se Informacionit për Sistemin e Drejtësisë"
- Vendimi nr. 6 dt. 17.12.2021 " Për miratimin e Udhërrëfyesit për Zhvillimin e Sistemit te ri te Menaxhimit te Çështjeve”.
- Referuar përgatitjes së paketës ligjore të nevojshme për funksionimin e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit masa është përmbushur me hartimin dhe miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 972, date 2.12.2020, “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë” (i cili përbën aktin e funksionimit të Qendrës). Vendimi ka për qëllim të përcaktojë rregulla mbi organizimin dhe kompetencat e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit, si organi që do të zbatojë politikat shtetërore të sistemit të teknologjisë së informacionit për organet e drejtësisë në funksion të politikave mbi sistemin e drejtësisë. Nëpërmjet këtij vendimi ngrihet Qendra dhe përcaktohen organet dhe kompetencat e tyre në koordinimin gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve të sistemit të drejtësisë për ngritjen e bazave të të dhënave shtetërore për sistemin e drejtësisë. Një nismë e tillë i shërben administrimit të sistemeve të teknologjisë që pritet të ngrihen pas reformës rrënjësore të sistemit të drejtësisë. Përcaktimet e bëra në këtë vendim janë hartuar duke mbajtur në fokus të veçantë ndarjen e pushteteve, por edhe në funksion të përmbushjes së delegimit ligjor të përcaktuar nga ligji për qeverisjen e sistemit gjyqësor.

❖ **Për Objektivin Specifik 4.1 është parashikuar 1 indikator:**

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e gjykatave/prokurorive për të cilat sistemi i ri i menaxhimit të çështjeve është ngritur dhe funksionon me kapacitet të plotë“ i ka si qëllim të vlerësojë funksionimin e plotë të sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve në gjykata dhe prokurori. Indikatori nuk mund të matet për vitin 2021.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

	2020	
	2021 (targeti i synuar)	0

Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i arritur)	Indikatori nuk mund të matet për këtë periudhë raportimi pasi fillon zbatueshmërinë pas vitit 2021.

Niveli i realizimit të objektivit 4.1

Niveli i realizimit të *Objektivit 4.1* “Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuar, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare” në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021. Indikatori nuk mund të matet për këtë periudhë raportimi pasi fillon zbatueshmërinë pas vitit 2021.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, QTI për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Risqet për realizimin e Objektivit 4.1

Risku i realizimit të këtij objektiv është i nivelit të lartë, pasi ka ndikim të lartë për shkak të faktorëve të lidhura me ngritjen, organizimin dhe funksionimin e QTI-së, si dhe me moszbatimin dhe mirëmbajtjen së sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve sipas standardeve aktuale teknologjike e legjislative.

Objektivi Specifik 4.2 “Përmirësimi i koordinimit, menaxhimit të performancës dhe sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS”.

❖ Plani i veprimit për Objektivin 4.2 parashikon 10 masa.

4.2.1	Funksionimi i plotë dhe marrja e masave për trajnime të vazhdueshme për sekretariatet teknike dhe grupet tematike në sektorin e drejtësisë në zbatim të mekanizmit GMIP-së.
4.2.2	Kryerja e analizës së thelluar të përputhshmërisë të kuadrit strategjik/ kapaciteteve institucionale të sektorit të drejtësisë me standardet IPSIS.
4.2.3	Trajnimi i sektorit të politikave dhe planifikimit strategjik në zbatim të Planit Kombëtar të të dhënave sistemike (NSDP 2020-2017) dhe IPSIS.
4.2.4	Kryerja e analizës së boshllëkut të statistikave të sektorit të Drejtësisë dhe propozimi i planit të përmirësimit në përputhje me NSDP-në.
4.2.5	Trajnime të kapaciteteve të sektorit të statistikave për rritjen e performancës së tyre.

4.2.6	Ndërmarrja e studimit të perceptimit të krimit dhe përdorimi si kontribut në programin e parandalimit dhe rishikimin e politikave dhe legjislacionit penal.
4.2.7	Kryerja e sondazheve të rregullta vjetore të perceptimit të aksesit në drejtësi, sondazhet e përdoruesve të gjykatave.
4.2.8	Ndërmarrja e vlerësimit të pavarur të komunikimit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë dhe zhvillimi i planit të përmirësimit.
4.2.9	Hartimi i planit të zhvillimit të kapaciteteve dhe mbështetja e institucioneve të sektorit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre të komunikimit.
4.2.10	Ndërmarrja e sondazhit mbi kënaqësinë dhe perceptimin e cilësisë së komunikimit dhe transparencës në sektor.


❖ **Për këtë objektiv janë përcaktuar 1 tregues performance:**

- % e përdoruesve të sistemit të trajnuar lidhur me standardet e performancës të sistemit IPSIS”

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e përdoruesve të sistemit të trajnuar lidhur me standardet e performancës të sistemit IPSIS“ është 25% për KLP/KLGJ/ILD.

Vlera bazë është 0. Nga të dhënat e raportuara rezlton se për vitin 2021 janë trajnuar 25% e stafit. Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit sipas Pasaportës së Treguesve, paraqitet si vijon:

	2020	0%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	25%
	2021 (targeti i arritur)	ILD 25%
		Realizuar në masën 100%



Niveli i realizimit të objektivit 4.2

Niveli i realizimit të *Objektivit 4.2 “Përmirësimi i koordinimit, menaxhimit të performancës dhe sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS”* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 **është 100%.**

Shkalla e realizimit të objektivit 4.2 për këtë periudhë raportimi është **100 %.**

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Risqet për realizimin e Objektivit 4.2

Risku i realizimit të këtij objektiv është i nivelit të mesëm duke shfaqur problematika dhe rreziqe lidhur me hartimin e planit për trajnime të vazhdueshme me qëllim zhvillimin e dhe rritjen e performancës.

Objektivi Specifik 4.3 “Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rritja e mbështetjes së saj për institucionet e saj të varësisë”

- ❖ Plani i veprimit për Objektivin 4.3 parashikon 6 masa.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2021-2025 janë parashikuar masat si më poshtë:

4.3.1	Kryerja e vlerësimit të nevojës për përmirësimin e kornizës ligjore dhe rregullatore të Ministrisë së Drejtësisë.
4.3.2	Hartimi dhe zbatimi i planit strategjik dhe të zhvillimit të kapaciteteve të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë (trajnimi).
4.3.3	Trajnime për përmirësimin e aftësive të menaxhimit të burimeve njerëzore.
4.3.4	Kryerja e analizës së situatën e kontrollit të brendshëm financiar në shërbimin e burgut, përfshirë kontrollin e brendshëm të MD-së për mbikëqyrjen e njësisë dhe përgatitja e një vlerësimi të detajuar të rrezikut në lidhje me administrimin financiar në burgje.
4.3.5	Kryerja e analizës së rishikimit të kornizës aktuale organizative dhe ligjore për inspektimet e burgjeve në funksion të praktikave evropiane.
4.3.6	Përgatitja e raporteve të inspektimit të përmbaruesve/noterëve bazuar në metodologjitë e miratuara.

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 4.3, ku më konkretisht përmendim:**

- Bazuar në VKM nr.138, datë 12.03.2014 “Për Rregullat e Organizimit e të Funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe Trajnimit e Nëpunësve Civil”, i ndryshuar, Sektori i Burimeve Njerëzore në muajin Nëntor i dërgon e-mail të gjithë punonjësve, të cilët, pas miratimit të eprorëve të tyre, me qëllim përmbushjen e nevojave për arritjen e objektivave të punës dhe detyrave funksionale, përcjellin temat e trajnimeve për të cilat kanë interes. Të gjitha temat e trajnimeve të përcjella pranë Sektorit të BNJ i dërgohen ASPA, me qëllim dhënien e kontributit për hartimin e kalendarit të trajnimeve për vitin pasardhës.
- Përsa i përket pjesëmarrjes së punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë për trajnime për përmirësimin e aftësive të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore janë trajnuar 2 punonjës.
- Në zbatim të Urdhër nr. 41, datë 01.02.2021 “Për miratimin e programit vjetor të noterëve për vitin 2021” është planifikuar inspektimi i 30 noterëve. Për vitin 2021 rezultojnë të jenë realizuar 19 inspektime të përgjithshme për noterët dhe 2 inspektime për përmbaruesit. (Theksohet se këtu nuk përfshihen rastet e dorëheqjeve, marrjes në dorëzim të arkivave apo rastet e mosushtrimit të veprimtarisë). Raportet bazuar metodologjive të miratuara mbi inspektimet e kryera nuk kanë përfunduar të gjitha, afërsisht 7 – 8 raporte të inspektimeve janë në proces.

❖ **Për këtë objektiv janë përcaktuar 3 tregues performance:**

- % e punonjësve të administratës së burimeve njerëzore të MD dhe institucioneve të varësisë të trajnuar lidhur me aftësitë menaxheriale dhe koordinuese.
- % e punonjësve të MD të trajnuar në fushën e inspektimit
- % e inspektimeve të kërkuara ligjërisht për noterët publikë të kryera nga MD


Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e punonjësve të administratës së burimeve njerëzore të MD dhe institucioneve të varësisë të trajnuar lidhur me aftësitë menaxheriale dhe koordinuese” për vitin 2021 është: 3%.

Gjatë vitit 2021, referuar vlerës së synuar për vitin 2021, **vlera e arritur është 2.1 %**. Indikatori është realizuar në masën 70%. Ky indikator ka si synim matjen e cilësisë së punës nga Ministrinë e Drejtësisë.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit paraqitet si vijon:

Vlera bazë	2020	2%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	3%
	2021 (targeti i arritur)	2.1% Realizuar 70 %

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:




Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e punonjësve të MD të trajnuar në fushën e inspektimit” për vitin 2021 është: 11%. Vlera bazë i referohet vitit 2020 pra 10%.

Referuar vlerës së synuar për vitin 2021 janë trajnuar 25% e punonjësve. Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore do të vijohet trajnimi mbi fushën e inspektimit. Indikatori është realizuar në vlerën 100%.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit paraqitet si vijon:

Vlera bazë	2020	10%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	11%
	2021 (targeti i arritur)	25% Realizuar 100 %

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë:



Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “% e inspektimeve të kërkuara ligjërisht për noterët publikë të kryera nga MD” për vitin 2021 është: 25%. Në zbatim të Urdhrit nr. 41, datë 01.02.2021 “Për miratimin e programit vjetor të ntoerëve për vitin 2021” është planifikuar inspektimi i 30 noterëve, nga të cilat janë realizuar 19.


Gjatë vitit 2021, targeti i arritur është është 63%. Vlerë është tejkaluar nga vlera e synuar për vitin 2021. Indikatori është realizuar në masën 100%.

Ky indikator ka si synim matjen e cilësisë së punës nga Ministrinë e Drejtësisë.

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit paraqitet si vijon:

Vlera bazë	2020	25%
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	25%
	2021 (targeti i arritur)	63% Realizuar në masën 100 %.

Realizueshmëria e indikatorit në mënyrë grafike është si më poshtë vijon:



Niveli i realizimit të objektivit 4.3

Niveli i realizimit të *Objektivit 4.3* “Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rritja e mbështetjes së saj për institucionet e saj të varësisë” në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021. Përlllogaritja është kryer sipas formulës së mëposhtme:

$$NR\ 4.3 = \frac{TP\ (70\%) + TP\ (100\%) + TP\ (100\%)}{3\ TP} \times 100\% = 90\%$$

Shkalla e realizimit të objektivit 4.3 për këtë periudhë raportimi është **90 shumë mirë (56 në 110 për qind e masave të realizuara)**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Qendra e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Risku për realizimin e Objektivit 4.3

Risku i realizimit të këtij objektiv është i nivelit të mesëm për shkak të rreziqeve të lidhura me mjedisin e brendshëm që lidhen me organizimin dhe bashkëpunimin si dhe me çështje të tjera që lidhen me mjedisin rregullativ. Pra ka mundësi të mesme risku dhe ndikim të ulët të tij.

Objektivi Specifik 4.4 “Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar dhe përgatitja e Shqipërisë për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis-in e BE dhe aktet e tjera të integritit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë”.

❖ Plani i veprimit për Objektivin parashikon 8 masa.

Për të arritur vlerat e këtij treguesi të performancës për vitet 2021-2025 janë parashikuar masat si më poshtë:

4.4.1	Përgatitja, konsultimi dhe miratimi i paketës ligjore në lidhje me rishikimin e ligjit për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet penale.
4.4.2	Ofrimi i trajnimeve për zhvillimin e kapaciteteve me zbatimin e legjislacionit të ri.
4.4.3	Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve institucionale të MD-së në lidhje me harmonizimin e legjislacionit me acquis BE dhe hartimi i planit të zhvillimit të kapaciteteve.
4.4.4	Trajnime të nëpunësve të Ministrisë së Drejtësisë në fushën e harmonizimit të legjislacionit.
4.4.5	Përgatitja e një plani/harte me gurët kilometrikë dhe objektivat për procesin e negocimit.
4.4.6	Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë për të menaxhuar fondet IPA III.
4.4.7	Zhvillimi i kapaciteteve të institucioneve të varësisë të Ministrisë së Drejtësisë (sistemi penitenciar, shërbimi i provës, ndihmë ligjore) për të menaxhuar fondet e IPA III.
4.4.8	Përgatitja e kapaciteteve të institucioneve të pavarura të drejtësisë (KLGJ, KLP, ILD, PP, SHM) për të përgatitur dhe menaxhuar fondet IPA III.

❖ **Për periudhën janar – dhjetor 2021 janë shënuar arritje në Objektivin Strategjik 4.4, ku më konkretisht përmendim:**

- Është rishikuar dhe miratuar Ligji Nr.10193 datë 3.12.2009 "Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet Huaja në Çështjet Penale" I ndryshuar 97/21 datë 7.7.2021.
- Gjithashtu gjatë vitit 2021 janë ofruar shërbime/trajnime në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve me legjislacionin e ri për 35 nëpunës civilë në fushat e procedurave administrative, civile dhe harmonizimit të legjislacionit.
- *Ministria e Drejtësisë në cilësinë e institucionit lider për Kriterin Politik dhe Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore", ka si objektive në kuadër të procesit të negociatave:*

-Përgatitjen për zhvillimin e Takimeve Bilaterale BE-Shqipëri; përditësimi dhe përmirësimi i dokumentave të analizës së mangësive ligjore (LGA), tabelave të përputhshmerisë (TOC) dhe analizës së mangësive institucionale dhe administrative (IAGA). Kapitullin 23, në bashkëpunim me MEPJ si dhe me projektin SEI.

-Përgatitja për hartimin e roadmap për shtetin e së drejtës në bashkëpunim me të gjitha institucionet kontribuese.

-Hartimi i planit masave në zbatim të rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020.

-Monitorimi i PKIE 2021-2023;

-Hartimi i PKIE 2022-2024;

-Forcimi i kapaciteteve të stafit të Drejtorisë së Integritetit dhe Negociatave, si dhe anëtarëve të GNPIE-së për Kriterin Politik dhe Kapitullin 23;

Në vijim të objektivave sa më lart përmendur përgjatë vitit 2021 janë realizuar si vijon:

Trajnim nga Projekti "Support to the EU Integration Process of Albania" (SEI), si dhe ASPA, në kuadër të përgatitjes për takimet bilaterale BE-Shqipëri janë zhvilluar.

-Workshop "Rule of law in the Negotiation Process" organizuar nga Projekti SEI;

-Trajnim "Përafrimi i legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së", organizuar nga Projekti SEI;

-Workshop "Towards EU Accession Negotiations Priorities of European Integration", organizuar nga Projekti SEI;

-Webinari "Përgatitja e Planit Kombëtar për Integritetin Evropian 2022-2024", organizuar nga Projekti SEI dhe ASPA;

-Konferenca "Towards EU Accession Negotiations: Preparing for bilateral screening", organizuar nga Projekti SEI "Support to the EU Integration Process of Albania";

-Gjithashtu përgjatë muajve qershor-tetor 2021, MD është asistuar dhe nga projekti IOM gjatë hartimit të tabelave të përputhshmerisë (TOC).

- Është hartuar plani i masave në mars të vitit 2021 për adresimin e rekomandimeve të raportit të KE për Shqipërinë të vitit 2020 si dhe ka vijuar monitorimi i tij

-Ka vijuar procesi i monitorimit të PKIE 2021-2023.

- Përgjatë vitit 2021 janë kryer trajnime të nëpunësve të Ministrisë së Drejtësisë në fushën e harmonizimit të legjislacionit.

❖ **Për këtë objektiv është përcaktuar 1 tregues performance:**


- Kohëzgjatje aktuale mesatare (ditë ose muaj) të procedurave kyçe të kooperimit ndërkombëtar krahasuar me kohëzgjatjen e synuar.

Vlera e synuar për **treguesin e performancës** “Kohëzgjatje aktuale mesatare (ditë ose muaj) të procedurave kyçe të kooperimit ndërkombëtar krahasuar me kohëzgjatjen e synuar” për vitin 2021 është: 03-06 muaj. Indikatori është realizuar në masën 100%. Është rishikuar dhe miratuar Ligji Nr.10193 datë 3.12.2009 "Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet Huaja në Çështjet Penale" i ndryshuar 97/21 datë 7.7.2021

Paraqitja e realizueshmërisë së treguesit paraqitet si vijon:

Vlera bazë	2020	3-6 muaj
Vlera e synuar/ Targeti	2021 (targeti i synuar)	3-6 muaj
	2021 (targeti i arritur)	3-6 muaj

Realizueshmëria e treguesit në mënyrë grafike paraqitet si më poshtë vijon:



Niveli i realizimit të objektivit 4.4

Niveli i realizimit të *Objektivit 4.4* “Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar dhe përgatitja e Shqipërisë për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis-in e BE dhe aktet

e tjera të integritit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë” në lidhje me realizimin e treguesve të performancës për periudhën janar - dhjetor 2021 është 100 %.

Shkalla e realizimit të objektivit 4.4 për këtë periudhë raportimi është **100% shumë mirë (56 në 110 për qind e masave të realizuara)**.

Verifikueshmëria e të dhënave

Të dhënat e raportuara mbi treguesit e performancës janë bazuar në informacionin e raportuar nga Ministria e Drejtësisë për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për periudhën janar - dhjetor 2021.

Risku për realizimin e Objektivit 4.4

Risku i realizimit të këtij objektivit është i nivelit të ulët, ka mundësi të ulët të ndodhjes dhe ndikim të ulët të tij, pasi nuk paraqet risk evident.

Realizueshmëria e objektivave specifike të qëllimit të katërt të strategjisë

Mbështetur në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe përpunimin e të dhënave të treguesve të performancës tabela më poshtë paraqet shkallën e realizimit të 4 objektivave specifike të qëllimit të tretë të politikës.

Realizueshmëria e Qëllimit të katërt të Politikës është **73%**.

Objektivi	Realizueshmëria
4.1 Zhvillimi i plotë i sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia) me identifikues të unifikuar, i sistemeve të menaxhimit të çështjeve të përditësuara, regjistrimit elektronik të bazuar në internet për të treja fushat (penale, administrative, civile) dhe lidhjeve me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare.	- ⁴⁹
4.2 Përmirësimi i koordinimit, menaxhimit të performancës dhe sistemeve të komunikimit përmes metodologjisë IPSIS.	100 %
4.3 Zhvillimi i kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe rritja e mbështetjes së saj për institucionet e saj të varësisë.	90 %
4.4 Përditësimi i kuadrit ligjor dhe kapaciteteve të MD-së dhe përmirësimet në fushën e bashkëpunimit ligjor ndërkombëtar dhe përgatitja e Shqipërisë për anëtarësimin në BE me anë të harmonizimit të legjislacionit shqiptar me acquis-in e BE dhe aktet e tjera të integritit me BE dhe shtetet anëtare në fushën e drejtësisë.	100 %

⁴⁹ Nuk mund të matet për vitin 2021. Fillon zbatueshmërinë në vitet në vijim.

III. PROGRESI LIDHUR ME OBJEKTIVAT REZULTATET DHE IMPAKTIN

3.1 Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur treguesit

Mbështetur në informacionin mbi vlerat e synuar të masave të realizuara, të treguesve të performances, realizimi i objektivave për *janar - dhjetor 2021* është si më poshtë.

Realizimi sipas masave	Realizimi sipas treguesve
Dobët – 4 objektiva	Dobët – 0 objektiva
Mjaftueshëm - 0 objektiva	Mjaftueshëm – 0 objektiv
Mirë - 8 objektiva	Mirë - 3 objektiva
Shumë mirë - 3 objektiva	Shumë mirë - 9 objektiva
Tejkaluar – N/A objektiv	Tejkaluar – 2 objektiva

3.2 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 31 dhjetor 2021*, rezulton se fushat që kanë treguar performance jo rezultative të shoqëruar nga problematika për këtë periudhë raportimi janë objektivë specifikë të shpërndarë në të katërta qëllimet e politikave.

Në adresimin e performancës nga institucionet rezulton se:

- 1- Rritja e ndërgjegjësimit dhe marrja e masave konkrete nga institucionet përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit për ti kushtuar vëmendje progresit për realizueshmërinë e masave që rezultojnë të pazbatuara, progresit për masat në proces zbatimi, si dhe indikatorëve të cilët nuk kanë arritur vlerat e synuara apo janë arritur pjesërisht për periudhën raportuese.
- 2- Rekomandim për përgatitjen e një plani pune të brendshëm nga institucionet e përfshira në planin e veprimit në kuadër të zbatueshmërisë të masave ku rezultojnë institucion përgjegjës/kontributor për të patur progres brenda afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit.
- 3- Vonesat në dërgimin e kontributit nga institucionet e përfshira në Planin e Veprimit në kuadër të përgjigjes të kërkesës që dërgohet nga Ministria e Drejtësisë. Në këtë kuadër, raportimi jashtë afatit ndikon drejtpërsëdrejti në hartimin me vonesë të draft-raportit të monitorimit.
- 4- Problematikë kryesore vijon të mbetet cilësia e kontributeve, të cilat shpesh janë ri-kthyer për t'u implementuar sipas kërkesave dhe në përputhje me formatin dhe standartin IPSIS.
- 5- Mungesa e një bashkëpunimi të mirë me sektorët e financës të pikave të kontaktit ka gjithashtu një ndikim të shtuar në vështirësitë e raportimit të kryer, më konkretisht të mungesës së informacionit që lidhet me ekzekutimin e buxhetit.

3.3 Konkluzionet kryesore

Ky raport monitorimi është në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektoriale dhe ndërsektorialë për agjendën e mirëqeverisjes në kuadër të programimit IPSIS. Raporti jep një informacion mbi zbatueshmërinë e qëllimeve të politikës, të objektivave specifike të strategjisë, të realizueshmërisë së treguesve sipas vlerave të synuara dhe ato të arritura. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe një identifikim të masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim.

Raporti i monitorimit *janar – dhjetor 2021*, përmban të dhëna statistikore dhe analitike bazuar mbi evidenca të matshme dhe të verifikueshme, mbi raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve zbatuese, mbi raporte dhe informacione të publikuara, konsultim me të gjithë faktorët (zbatues dhe vlerësues të procesit) e të dhëna mbi raport progresin e treguesve mbi baza krahasimore për çdo objektiv të strategjisë.

Në përfundim të këtij procesi, në raportimin e periudhës pasardhëse sugjerohet që institucionet të mbajnë në konsideratë:

- të raportohet në kohë në përgjigje të kërkesës së raportimit që dërgohet nga Ministria e Drejtësisë, pasi mosraportimi në kohë për këtë periudhë monitoruese nga disa pika kontakti ka ndikuar në kryerjen e një analizë reale dhe të saktë të zbatueshmërisë së planit të veprimit.
- Rekomandohet të raportohen të dhëna të sakta dhe të verifikueshme, në çdo rast vlerat e dhëna duhet të jenë të arsyetuara.
- të vijojë e të përmirësohet performanca e kryerjes së masave në kuadër të realizimit të vlerave të synuara për vitin 2021;
- të përmirësohet arritja e vlerave të synuara në treguesit për objektivet
- të raportohet informacioni mbi buxhetin e përdorur për masat e planit të veprimit, buxheti i shpenzuar për realizimin e masave të mbuluara nga donatorët (informacion i cili nuk disponohet nga të gjitha pikat e kontaktit pranë institucioneve raportuese); buxhetin e shpenzuar për realizimin e masave të mbuluara nga buxheti i shtetit e të krijohet një bashkëpunim më i mirë për qëllime raportimi me strukturat/stafet teknike të financës/buxhetit pranë institucioneve raportuese, pasi në kuadër të raportimit kjo është një përgjegjësi e pikave të kontaktit. Rezulton se ka ende institucione përgjegjëse për zbatimin e këtij plani veprimi, që nuk kanë raportuar informacionin mbi buxhetin e përdorur (referohu aneksit të draft raportit).

IV. RISQET/RISKU DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

4.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit

Në këtë raport monitorimi, *janar – dhjetor 2021*, është kryer vlerësimi i riskut për çdo objektiv në përputhje me analizën e riskut të sjell prej institucioneve përgjegjëse ose në mungesë të kësaj analize, të vlerësimit që vetë stafi i ka bërë riskut në përputhje me nivelin e realizueshmërisë së objektivave.

Ndër risqet që u evidentuan kryesisht, janë të lidhura me kapacitetet institucionale, kapacitetet financiare, mjedisin rregullator, partneriteti dhe bashkëveprimi institucional, komunikimi, proceset e punës por dhe faktorë të tjerë të jashtëm.

Objektivë me risk të ulët janë: 4 objektiva (objektivi: OS 2.3, OS 3.1, OS 3.2, OS 4. 4).

Objektivë me risk të mesëm janë: 6 objektiva (objektivi: OS 1.1; OS 1.2 ; OS 1.3 ; OS 2.1; OS 2.2; OS 3.5; OS 4.3).

Objektivë me risk të lartë janë: 5 objektiva (objektivi: OS 2.4, OS 2.5, OS 3.4, OS 4.1, OS 4.2).

4.2 Hapat e radhës dhe rekomandimet

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën për periudhën *janar-dhjetor 2021*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, adresohen të ndërmerren hapa në vijim në kuadër të përmbushjes të masave të cilat rezultojnë të përfunduar për këtë periudhë monitorimi. Në adresimin e përmirësimit të performancës nga institucionet rekomandohet që për secilën prej tyre duhet të ndërmerren masa konkrete për progres në raportimin pasardhës mbi:

- **Mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale)**

Konkretisht në vijim duhet të ndërmerren hapa mbi masat **1.3.2** “Përfundimi i procedurave të emërimit të inspektorëve magjistratë dhe jo-magjistratë pranë ILD-së si dhe përfundimi i rekrutimeve të stafit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”; **3.2.12** “Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të BKH-së”; **3.4.19** “Rritja e kapaciteteve të stafit për të siguruar një normë prej 50 stazhierësh për staf në përputhje me standartet evropiane dhe për të siguruar stafin e duhur për zyrat vendore, si dhe struktura e pagave u rishikua për të siguruar pagesën e duhur në të gjithë organizatën sipas aftësive dhe përgjegjësive në përputhje me skemën zyrtare të pagave.

- **Përgatitja e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik të institucioneve referuar masave të parashikuara për zbatim**

Konkretisht duhet të ndërmerren hapa në vijim mbi masat **1.3.5** “Përgatitja e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin infrastrukturor dhe logjistik të ILD për pajisjen me ambiente pune/logjistikë për të gjithë numrin e punonjësve të ILD-së”; **3.4.7** “Dizenjimi dhe instalimi i teknologjisë së informacionit bashkëkohor si dhe sistemit të administrimit të çështjeve, duke

krijuar lidhje me sistemin e integruar të drejtësisë elektronike”; **4.1.1** “Dizenjimi i programit të digjitalizimit të institucioneve të drejtësisë; **4.1.2** “Ngritja dhe zbatimi i programit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykata/KLGJ/KLP/ILD” **2.4.8** “Krijimi i infrastrukturës për të ngritur një njësi për pritjen e publikut pranë ILD-së” **4.1.11** “Trajnimi i trupës gjyqësore/prokurorë/inspektorë dhe i stafit administrativ mbi përdorimin e sistemit të ri të menaxhimit të çështjeve”

- **Vonesa në kryerjen e procedurave/fazave mbi hapa specifike si finalizimet e rishikimit të kuadrit ligjor të institucioneve të caktuara janë arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit**

Konkretisht duhet të ndërrmeren hapa në vijim mbi masat **1.2.7** “Finalizimi i rishikimit të kuadrit ligjor të lidhur me qeverisjen e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në, konsultimi dhe miratimi i akteve); **2.1.5** “Përgatitja, diskutimi dhe miratimi i paketës së ndryshimeve të nevojshme të Kodit të Familjes (KF)”; **4.3.7** “Kryerja e analizës së rishikimit të kornizës aktuale organizative dhe ligjore për inspektimet e burgjeve në funksion të praktikave evropiane”

- **Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional**

Konkretisht duhet të ndërrmeren hapa në vijim mbi masat **2.5.8** “Krijimi i forumit të bashkëpunimit të DNJF-së me grupe të tjera të interesit në sektorin gjyqësor dhe përgatitja e planit për funksionimin dhe zhvillimin e tij” **3.4.5** “Konsolidimi dhe finalizimi i marrëveshjeve të binjakëzimit/bashkëpunimit me partnerët institucionalë evropianë” **3.4.18** “Përgatitja e programeve të bashkëpunimit me KLGJ-në, KLP-në, PP-në, SHM-në për të informuar për qasjet e reja dhe mundësitë e një shërbimi modern sipas standardeve evropiane” **3.5.18** “Hartimi, Konsolidimi dhe finalizimi i memorandumit të bashkëpunimit me MSHMS për kujdesin dhe trajtimin e shkelësve të papërgjegjshëm dhe në kujdesin e pacientëve të dënuar me probleme mendore dhe të atyre në paraburgim dhe memorandum me institucionet e tjera” **3.2.4** “Konsultimi i paketës së propozimeve me grupet e interesit (workshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi i ligjit organik të prokurorisë, të ndryshuar”

- **Marrja e masave për trajnime të vazhdueshme nga institucionet e përfshira në Plan Veprimi**

Konkretisht duhet të ndërrmeren hapa në vijim mbi masat **4.2.1** “Funksionimi i plotë dhe marrja e masave për trajnime të vazhdueshme për sekretariatet teknike dhe grupet tematike në sektorin e drejtësisë në zbatim të mekanizmit GMIP-së” **4.3.2** “Hartimi dhe zbatimi i planit strategjik dhe të zhvillimit të kapaciteteve të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë (trajnimi)”

Hapat kryesore mbi vijimin e progresit në objektivët me realizueshmëri të ulët:

Objektivi 1.1: Vazhdimi i zbatimit dhe finalizimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mënyrë efektive dhe efikase sipas parashikimeve të Kushtetutës dhe ligjit.

Objektivi 1.2: Të miratohet procedura e vlerësimit të prokurorëve për të plotësuar komponentin lidhur me KLP me synim përgatitjen e analizës së zbatimit të reformës në sistemin e drejtësisë bazuar në komponentin e lidhur me KLP-në.

Objektivi 1.3 Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë vitit 2022, duhet të vijojë me procedurat për rekrutimin e inspektorëve jo-magjistratë si dhe për ngritjen e kërkesave pranë këshillave përkatës, për komandimin e inspektorëve magjistratë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Objektivi 2.2 Hapja e thirrjeve dhe plotësimi i vakancave në Gjykatën Kushtetuese.

Objektivi 2.4 Realizueshmëria e masave të Këshillit të Lartë Gjyqësor në kaudër të përmirësimit të sistemit gjyqësor me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor, duke përfshirë GJL-në, dhe sigurimi i ofrimit të drejtësisë transparente, pa vonesa dhe të aksesueshme për qytetarët.

Objektivi 3.2 Finalizimi i draft paketës së propozimeve me grupet e interesit (ëorkshop) dhe hartimi i raporteve të konsultimit/finalizimi i paketës dhe miratimi i ligjit organik të prokurorisë, të ndryshuar.

Objektivi 3.2 Konsolidimi i burimeve njerëzore për funksionimin e plotë të BKH-së.

Objektivi 3.4 Marrja e masave për të konsoliduar dhe finalizuar marrëveshjeve të binjakëzimit/bashkëpunimit me partnerët institucionalë evropianë.

Objektivi 4.1 Finalizimi dhe funksionimi plotësisht i programit të digjitalizimit të institucioneve të drejtësisë.

